



unicef 
for every child

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARASHKOLLOR

2018



**KORNIZA KURRIKULARE
E ARSIMIT PARASHKOLLOR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr. 207 Prot.

Tiranë, më 12.01.2017

URDHËR

Nr. 8, datë 12.01.2017

PËR
MIRATIMIN E "KORNIZËS KURRIKULARE TË ARSIMIT PARASHKOLLOR" DHE
"STANDRDEVE TË ZHVILLIMIT DHE TË TË NXËNIT TË FËMIJËVE 3-6 VJEÇ"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 25 dhe 26 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

URDHËROJ:

1. Miratimin e "Kornizës kurrikulare të arsimit parashkollor" dhe "Standardeve të zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç"
2. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR



Publikimi “**Korniza Kurrikulare e Arsimit Parashkollor**” u realizua në kuadër të bashkëpunimit të Institutit të Zhvillimit të Arsimit me UNICEF-in. Opinionet dhe sugjerimet e paraqitura në këtë botim i përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht këndvështrimet e UNICEF. Manuali u hartua nën kujdesin e znj. Mirlinda Bushati, drejtuese e programit të Edukimit dhe Fëmijërisë së herhme në UNICEF Shqipëri.

UNICEF-i mundësoi mbështetjen financiare dhe teknike si dhe falë kontributit dhe konsulencës së ekspertes ndërkombëtare, Sharon Lynn Kagan Ed.D nga Kolegji i Mësuesve, Universiteti i Kolumbias, Qendra e Studimit për Fëmijët, Universiteti Yale, ShBA, u hartua dokumenti i Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parashkollor.

Grupi i punës u udhëhoq nga:

Gerti Janaqi, Drejtor i Institutit të Zhvillimit të Arsimit.

Aurela Zisi, Specialiste e arsimit fillor dhe parashkollor, IZHA.

Në hartimin e Kornizës Kurrikulare kanë kontribuar specialistë të arsimit parashkollor nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, specialistë të arsimit parashkollor pranë Drejtorive Arsimore Rajonale, pedagogë të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të Fakulteteve të mësuesisë, mësues dhe drejtues të arsimit parashkollor, përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile etj.

Në këtë dokument të rëndësishëm, kontribut të veçantë kanë dhënë specialistët Rozalba Merdani, Shqiponja Lamçe, Ermira Kurti, Mariana Sinani, Evis Mastori, Ermelinda Ikononi, Vasilika Shtëpani, Eniana Veli, Elona Hasko, Lindita Lutaj, Majlinda Ucaj, Anila Bozaxhiu, Majlinda Xhamo dhe Jonida Matohiti.

© **Copyright 2018**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për IZHA dhe UNICEF, Tiranë, Shqipëri

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----------|
| PËRMBAJTJA..... | 3 |
| KORNIZA KURRIKULARE – DOKUMENT POLITIK, AKADEMIK DHE PROCEDURAL..... | 8 |
| 1.1 Statusi i dokumentit..... | 8 |
| 1.2 Korniza Kurrikulare si koncept përmbajtësor dhe teorik | 8 |
| 1.3 Koherenca me Kornizën e Arsimit Parauniversitar si detyrim dhe si fakt | 10 |
| 1.4 Korniza Kurrikulare - dokumenti më i rëndësishëm në aspektin procedural..... | 10 |
| 1.5 Korniza Kurrikulare - dokumenti më i rëndësishëm në aspektin akademik: | 10 |
| 1.6 Arsimi parashkollor – Konteksti | 11 |
| 1.7 Rezultatet e pritshme në përfundim të arsimit parashkollor..... | 11 |
| 1.8 Struktura - Organizimi i kurrikulës në nivele | 11 |
| 1.8.1 Edukimi në fëmijërinë e hershme – Niveli O..... | 12 |
| 1.8.2 Niveli I - Përvetësim themelor | 13 |
| BAZAT E KURRIKULËS: VLERAT, PARIMET, KOMPETENCAT KYÇE, STANDARDET | 15 |
| 2.1 Vlerat universale dhe kombëtare..... | 15 |
| 2.2 Kurrikula e qëllimshme, procedurale, dhe me instrumente vlerësimi | 15 |
| 2.3 Parimet e përgjithshme që orientojnë zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës | 16 |
| 2.3.1 Kurrikula e gjerë me bazë kompetencash | 16 |
| 2.3.2 Baraspesha dhe integrimi si parim..... | 17 |
| 2.3.3 Vijimësia si parim..... | 17 |
| 2.3.4 Gjithëpërfshirja si parim | 18 |
| 2.3.5 Respekti për të ndryshmen si parim..... | 18 |
| 2.3.6 Qasja ndaj besimeve si parim..... | 18 |
| 2.3.7 Barazia gjinore si parim | 19 |
| 2.3.8 Bashkëpunimi dhe partneriteti si parim | 19 |
| 2.3.9 Autonomia dhe fleksibiliteti si parim | 20 |
| 2.4 Standardet e Zhvillimit dhe të të Nxënit të fëmijërisë së hershme..... | 20 |

| | | |
|--|--|-----------|
| 2.5 | Kompetencat për nxënien gjatë gjithë jetës..... | 21 |
| TEORITË MBI ZHVILLIMIN E FËMIJËS – PIKËNISJE PËR KURRIKULËN | | 25 |
| 3.1 | Fakte të konfirmuara: Nevojat e fëmijëve nga 3-6 vjeç | 25 |
| 3.1.1 | Nevoja për besim dhe siguri si fakt i konfirmuar | 25 |
| 3.1.2 | Nevoja për dashuri si fakt i konfirmuar | 25 |
| 3.1.3 | Nevoja për kohën e duhur në lojë si fakt i konfirmuar..... | 25 |
| 3.1.4 | Nevoja për të qenë i pavarur si fakt që duhet menaxhuar..... | 26 |
| 3.1.5 | Nevoja për eksplorim, vëzhgim | 26 |
| 3.1.6 | Nevoja për veprimtari fizike si fakt i konfirmuar | 26 |
| 3.1.7 | Nevoja të shkëmbejnë përvojat me bashkëmoshatarët dhe të rriturit..... | 26 |
| 3.1.8 | Nevoja për të njohur veten - fakt i konfirmuar | 27 |
| 3.2 | Teoritë zhvillimore të rritjes dhe teoritë zhvillimore të të nxënit..... | 27 |
| 3.2.1 | Teoria zhvillimore Erikson | 27 |
| 3.2.2 | Teoria humaniste Maslow | 31 |
| 3.2.3 | Zhvillimi konjitiv i fëmijës sipas Piazhësë | 32 |
| 3.2.4 | Zhvillimi konjitiv i fëmijës sipas Vigotskit | 35 |
| 3.2.5 | Teoria e zhvillimit ekologjik të fëmijës - sipas Urie Bronfenbrenner | 37 |
| METODOLOGJITË E TË NXËNIT REFERUAR KURRIKULËS NË ARSIMIN PARASHKOLLOR | | 41 |
| 4.1 | Mësimdhënia dhe të nxënit në Arsimin parashkollor | 41 |
| 4.1.1 | Pse mësojnë fëmijët?..... | 41 |
| 4.1.2 | Kur mësojnë fëmijët? | 41 |
| 4.1.3 | Si mësojnë fëmijët?..... | 42 |
| 4.2 | Metodat pedagogjike në parashkollor | 42 |
| 4.2.1 | Metoda e bazuar në lojë | 43 |
| 4.2.2 | Metoda e përqendruar te fëmija..... | 45 |
| 4.2.3 | Metoda e bazuar te integrimi tematik | 46 |
| 4.2.4 | Metoda e bazuar në projekte | 47 |
| 4.2.5 | Metoda multikulturore..... | 48 |

| | | |
|---|---|-----------|
| 4.3 | Gjithëpërfshirja në kurrikulën e arsimit parashkollor – si parim, metodë dhe detyrim ligjor | 48 |
| 4.4 | Partneriteti me prindërit dhe komunitetin si parim edukimi, detyrim ligjor dhe metodat për përfshirjen e tyre | 49 |
| KURRIKULA REFERUAR STANDARTEVE TË ZHVILLIMIT DHE TË NXËNIT DHE KORRELACIONI MIDIS TYRE | | 53 |
| 5.1 | Kurrikula si konfirmim i Standardit dhe i Kompetencave..... | 53 |
| 5.2 | Standardet në arsimin parashkollor..... | 53 |
| 5.2.1 | Organizimi dhe struktura e standardeve. | 56 |
| 5.3 | Të mësuarit dhe zhvillimi në fëmijërinë e hershme | 59 |
| 5.3.1 | Fusha 1. Gjuha dhe komunikimi. | 60 |
| 5.3.2 | Fusha 2. Matematika..... | 61 |
| 5.3.3 | Fusha 3. Shkencat e natyrës..... | 62 |
| 5.3.4 | Fusha 4. Shoqëria dhe Mjedisi | 63 |
| 5.3.5 | Fusha 5. Artet | 63 |
| 5.3.6 | Fusha 6. Edukimi Fizik, sportet dhe shëndeti | 63 |
| MJEDISI FIZIK DHE QENDRAT E TË NXËNIT | | 66 |
| 6.1 | Mjedisi fizik - kusht për cilësi, standard dhe kompetencë në intitucionet parashkollore 66 | |
| 6.2 | Hapësirat ku fëmijët mësojnë, zhvillohen dhe ndërveprojnë | 67 |
| 6.2.1 | Godina e Kopshtit..... | 67 |
| 6.2.2 | Mjedisi i Jashtëm | 68 |
| 6.2.3 | Mjediset e Brendshme | 68 |
| 6.2.4 | Paisjet | 69 |
| 6.3 | Qendrat e Veprimtarive | 70 |
| 6.3.1 | Rwndwsia e qendrave | 70 |
| VLERËSIMI | | 77 |
| 7.1 | Vlefshmëria dhe konfidencialiteti | 78 |
| 7.2 | Kriteri Arsimor në vlerësim | 78 |
| 7.3 | Transparehca në vlerësim | 78 |

| | | |
|-----------------------------------|------------------------------|-----------|
| 7.4 | Paanshmëria në vlerësim..... | 79 |
| 7.5 | Vlerësim tërësor | 79 |
| BURIMET E LITERATURËS..... | | 80 |

KAPITULLI I

KORNIZA KURRIKULARE DOKUMENT POLITIK, AKADEMIK DHE PROCEDURAL

KORNIZA KURRIKULARE – DOKUMENT POLITIK, AKADEMIK DHE PROCEDURAL

1.1 Statusi i dokumentit

Korniza Kurrikulare e arsimit parashkollor, ka statusin e dokumentit politik, me fuqi gjithëkombëtare. Nga ky dokument rrjedhin të gjithë dokumentet e tjerë, që përmbushin qëllimin e mirërritjes¹ dhe të edukimit të fëmijës në moshat 3-6 vjeç.

Korniza Kurrikulare e arsimit parashkollor rrjedh dhe përmbush frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe përmbajtjen e Ligjit për Arsimin Parauniversitar². Dokumenti në fjalë, përcjell fuqi kushtetuese në aspektin politik, social, akademik. Kjo, e bën këtë dokument të detyrueshëm për t’u përmbushur nga: institucionet e arsimit parashkollor, ekspertët e arsimit, që ushtrojnë dijen e tyre në këtë sistem shkollimi, stafet profesionale që përcjellin mirërritje dhe edukim në sistemin parashkollor, institucionet rajonale dhe vendore që përthyejnë frymën e këtij dokumenti në objektiva vendorë.

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parashkollor është në rezonancë të plotë me kurrikulën në arsimin e detyruar. Dokumenti është i konceptuar, duke iu referuar dimensioneve themelore në mirërritje dhe edukim të fëmijës në grupmoshat 3-6 vjeç:

- a. Respektim i individualitetit të fëmijës.
- b. Gjithëpërfshirje e fëmijës përtej çdo lloj paragjykimi.
- c. Diversitet kulturor si fakt dhe si vlerë.
- d. Dimension gjinor përtej stereotipisë.

1.2 Korniza Kurrikulare si koncept përmbajtësor dhe teorik

Kurrikula, është një sistem i integruar i elementeve me synime arsimore, që orientojnë dhe mundësojnë zbatimin në sistem të politikave arsimore dhe administrative, në përshtatje me realitetet shoqërore, historike, ekonomike e kulturore të një vendi.

¹ Ky cikël shkollimi ka fokus mirërritjen dhe edukimin njëkohësisht.

² Referuar Ligjit të Arsimit Parauniversitar: “Institucion arsimor” është kopshti ose shkolla.

Kurrikula, është dokument i shkruar nga ekspertë dhe i konsultuar me grupe të ndryshme interesi që e zbatojnë kurrikulën në terrenin e së përditshmes në institucionet parashkollore.

Ky dokument {Korniza Kurrikulare}, i referohet teorive më të njohura të zhvillimit të fëmijës, të cilat janë të konfirmuara; përshkruan besimet e ekspertëve që hartojnë dokumente të këtij niveli; përcakton procedurat që përmbushin përmbajtjen e dokumentit; liston metodologjitë më të njohura që përmbushin kurrikulën; përcakton fushat e të nxënit, kompetencat, instrumentet e vlerësimit, materialet dhe burimet që përdoren për të ndihmuar fëmijën të arrijë qëllimet e vendosura.

Në kurrikul, përcaktohet se çfarë duhet të dinë dhe çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë fëmijët e grupmoshës 3-6 vjeç; cilat vlera e qëndrime duhen kultivuar; si duhen aftësuar ata për bashkëjetesë e tolerancë me njëri-tjetrin, por jo vetëm; si mund të japin ndihmesë në mënyrë aktive për mirëqenien shoqërore dhe vetjake.

Kurrikula, konfirmon nevojën që në moshën parashkollore, aftësitë e fëmijëve duhet t'i drejtohen të nxënit të pavarur, zgjidhjes së problemeve, si dhe zhvillimit të mendimit kritik, përgjegjësiive për veten e për të tjerët. Këto aftësi dhe të tjera lidhen sot me *konceptin e kompetencave për të nxënit gjatë gjithë jetës*, të cilat mundësojnë përgatitjen e individëve për pjesëmarrje cilësore dhe aktive në shoqëri.

Në këtë dokument janë parashtruar:

- Qëllimi i arsimit parashkollor, si pjesë e qëllimit të përgjithshëm të arsimit parauniversitar;
- Parimet e përgjithshme, mbi të cilat ndërtohet zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulës;
- Kompetencat kyçe, që fitohen nga fëmijët e moshës 3-6 vjeç;
- Standardet, fushat e të nxënit dhe rezultatet e të nxënit për secilën fushë;
- Veçoritë e të mësuarit dhe kontekstualizimi në moshën parashkollore;
- Instrumentet e vlerësimit të zhvillimit të fëmijëve 3-6 vjeçarë;
- Dokumentet kurrikulare që e shoqërojnë.

1.3 Koherenca me Kornizën e Arsimit Parauniversitar si detyrim dhe si fakt

Koherencat në problematikë, procedurë, fusha të nxëni dhe kompetenca kyçe janë konsideruar nga ekipet e ekspertëve, si detyrim dhe si metodologji mbi të cilën është prodhuar Korniza Kurrikulare.

Dokumenti, është prodhur në respekt të faktit, se: Reforma Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, do të ishte e paplotë dhe e vështirë për t'u realizuar nëse nuk do të prodhohej Korniza e Arsimit Parashkollor, stad "substancial" edukimi, që përgatit fëmijën parashkollor³ në procesin e integritimit në stadet e mëtejshme të shkollimit.

1.4 Korniza Kurrikulare - dokumenti më i rëndësishëm në aspektin procedural

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parashkollor është një dokument shumë i rëndësishëm përse i përket aspektit procedural sepse ky dokument:

- Liston udhëzimet kryesore për qëllimin final në mbyllje të ciklit moshor, brendinë, mënyrat e nxënies dhe arritjet e fëmijëve parashkollorë.
- Orienton faktorët dhe aktorët arsimorë, palët e interesuara për aspektet kryesore të kurrikulës, sipas një itinerari të mirëpërcaktuar.

1.5 Korniza Kurrikulare - dokumenti më i rëndësishëm në aspektin akademik:

Korniza Kurrikulare, për moshën 3-6 vjeç, merr në konsideratë teoritë e konfirmuara të zhvillimit dhe të të nxënit për këtë grupmoshë të cilat i japin rëndësi të veçantë aspektit akademik që ato përcjellin.

Mbi këtë bazë, janë prodhuar Standardet e Zhvillimit dhe të të Nxënit, janë listuar fushat e të nxënit, është përcaktuar mjedisi i të nxënit, është konfirmuar domosdoshmëria e partneritetit me familjen, si dhe janë përcaktuar kriteret me të cilat realizohet vlerësimi i zhvillimit dhe i arritjeve të fëmijëve parashkollorë.

³ Parashkollori, është term me të cilin operohet në grupmoshën 3-6 vjeç, atëherë kur fëmija frekuenton Institucionin parashkollor-kopshtin.

Dokumenti operon me termin fëmijë parashkollor, referuar kontekstit ku bëhet parashtrimi.

1.6 Arsimi parashkollor – Konteksi

Arsimi parashkollor përmbushet brenda kontekstit socio-kulturor amë, në respekt të frymës globale të edukimit. Ai i referohet traditës më pozitive, që është “konservuar” ndër dekada në sistemin tonë parashkollor. Po kështu, merr parasysh modelet e konfirmuara në nivel evropian, dhe më tej, si “Montesori”, “Rexho Emilia” e “Hap pas Hapi” të cilat janë konfirmuar edhe në kontekstin tonë socio-kulturor e edukativ.

1.7 Rezultatet e pritshme në përfundim të arsimit parashkollor

Në përfundim të ciklit të edukimit të arsimit parashkollor, fëmija 3-6 vjeç pritet të ketë zhvilluar sjellje, reagime, veprime që dëshmojnë se ai/ajo:

- njeh dhe kupton veten dhe të tjerët përreth;
- kupton dhe pranon atë që është ndryshe ose e ngjashme tek objektet, bashkëmoshatarët etj;
- krijon një sjellje modeste, përmes së cilës përcjell tolerancë, mirëkuptim, bashkëpunim etj.;
- shpreh ndjenjat vetjake dhe dallon mënyrat e shprehjes së tyre nga të tjerët;
- përdor gjuhën amë, për të shprehur ndjenjat dhe mendimet e veta;
- zotëron shprehi të thjeshta komunikuese dhe artistike;
- përdor njohuri të thjeshta në jetën e përditshme;
- kujdeset në mënyrë të pavarur për higjienën vetjake dhe të mjedisit përreth.

1.8 Struktura - Organizimi i kurrikulës në nivele

Kurrikula e arsimit parashkollor është e organizuar në nivele. Secili nivel i referohet karakteristikave të përbashkëta, të cilat shoqërojnë proceset e zhvillimit të fëmijëve. Nivelet, shërbejnë si pika referimi për përcaktimin e kompetencave kryesore, të cilat duhen zotëruar respektivisht për secilin nivel.

Organizimi i kurrikulës në nivele mundëson:

- respektimin e karakteristikave të zhvillimit të fëmijëve gjatë fëmijërisë së hershme, me qëllim përcaktimin e procedurave specifike dhe të kompetencave, që duhen zotëruar prej tyre;

- respektimin e ritmeve individuale që paraqet çdo fëmijë drejt zotërimit të kompetencave të detajuara, në çdo nivel të kurrikulës;
- fleksibilitet në planifikimin dhe organizimin e procedurave mësimore- edukative nëpërmjet zgjerimit të ciklit të planifikimit nga një vit shkollor në dy dhe tre vite shkollore;
- përgatitjen e udhëzimeve të detajuara për organizimin e punës mësimore- edukative sipas niveleve, duke theksuar fleksibilitetin e regjimit ditor, metodat aktive të të nxëniet, ndërthurjen e llojeve të ndryshme të veprimtarive mësimore, argëtuese, çlodhëse; vëzhgimin, matjen dhe vlerësimin e zhvillimit të fëmijëve.
- forcimin e llogaridhënies së institucionit arsimor dhe të autoriteteve vendore të arsimit për cilësinë e arsimit që ofrohet në secilin nivel.

1.8.1 Edukimi në fëmijërinë e hershme – Niveli 0

Ky edukim përfshin periudhën prej lindjes së fëmijës deri në moshën 5 vjeçare, gjatë së cilës fëmijët mbështeten:

- në zhvillimin e përgjithshëm individual;
- në zhvillimin e aftësive për të komunikuar në gjuhën amtare, nëpërmjet veprimtarive të cilat ndihmojnë shqiptimin e drejtë të fjalëve, pasurimin e fjalorit dhe ushtrimin e aftësisë për të dëgjuar të tjerët;
- në zhvillimin fizik dhe ushtrimin e koordinimit të lëvizjeve trupore, zhvillimin e forcës, të ekuilibrit, zhvillimin e muskujve të vegjël, koordinimin sy-dorë dhe aftësimin e manipulimit me objekte të ndryshme të përdorimit ditor;
- në rritjen dhe zhvillimin gradual për veten, për të tjerët dhe për mjedisin që i rrethon;
- në zhvillimin e aftësive për të respektuar rregullat, për të dalluar sjelljen e drejtë dhe të gabuar.

- në nxitjen për t’u përfshirë në veprimtari praktike, për të dalluar dhe vlerësuar rreziqet, si dhe për të respektuar rregullat elementare të higjienës e të sigurisë.

1.8.2 Niveli I - Përvetësim themelor

Ky nivel i korrespondon klasës përgatitore (mosha 5-6 vjeç), klasës I dhe klasës II. Në këtë nivel, qëllimshëm organizohet dhe nxitet të mësuarit konkret, nëpërmjet situatave praktike të të nxënit. Fëmija parashkollor orientohet drejt të nxënit sistematik dhe të qëndrueshëm. I gjithë procesi i të nxënit mësimor-edukativ përqendrohet në:

- njohjen dhe të kuptuarit e të drejtave, detyrave dhe përgjegjësive në grup, në kopsht, në familje;
- përvetësimin e elementeve themelore të leximit e shkrimit në gjuhën amtare;
- përvetësimin e elementeve themelore të llogaritjeve numerike;
- hulumtimin e mjedisit fizik dhe natyror në mënyrë sistematike;
- përmbushjen e detyrave të caktuara përkundrejt afateve kohore.

KAPITULLI II

**BAZAT E KURRIKULËS:
VLERAT, PARIMET, KOMPETENCAT
KYÇE, STANDARDET**

BAZAT E KURRIKULËS: VLERAT, PARIMET, KOMPETENCAT KYÇE, STANDARDET

2.1 Vlerat universale dhe kombëtare

Në këtë stad edukimi kontakti me vlerat universale dhe kombëtare merret në mënyrën më të natyrshme, spontane dhe pothuajse në kushtet e një sjelljeje të virgjër. Disa nga vlerat kombëtare janë: respektimi i të drejtave të fëmijëve; tolerance; mirëkuptimi; ndërveprimi dhe të ndarit të përvojave dhe të gjërave me njëri-tjetrin; barazia gjinore; gjithëpërfshirja; autonomia; vetëbesimi, atdhedashuria; trashëgimia e vlerave kulturore; si dhe përfshirja e prindërve dhe e komunitetit në kopsht.

Kurrikula, është dokumenti që sistemon dhe përcjell vlera në masën dhe mënyrën e duhur në pikëpamjen akademike dhe procedurale. Vlera universale, si: dashuria për tokën, natyrën, bashkëmoshatarin, i cili/e cila nuk flet gjuhën tënde; përkujdesi për një të moshuar me të cilin nuk je takuar kurrë, janë disa nga vlerat universale, që çdo fëmijë i përvetëson nga të rriturit.

2.2 Kurrikula e qëllimshme⁴, procedurale⁵, dhe me instrumente vlerësimi⁶

Nëpërmjet kurrikulës, fëmijët parashkollorë nisin të kuptojnë, të respektojnë, të kultivojnë atë që është kombëtare, atë që është traditë e familjes; të kultivojnë dhe të kontribuojnë në pasurimin e trashëgimisë së tyre kulturore, të rajonit ku jetojnë dhe më gjerë.

Gjithashtu, fëmijët aftësohen të ndërtojnë në mënyrë krijuese dijet dhe shkathtësitë e tyre në situata të ndryshme dhe kontekste të reja; të angazhohen në mënyrë individuale

⁴ Kurrikula është dokument i qëllimshëm përsa kohë detyrimisht duhet të përcjellë dhe të përmbushë frymën e ligjit dhe është e detyrueshme të zbatohet substanca e saj nga çdo institucion parashkollor publik dhe privat.

⁵ Procedurale - Kurrikula ndërtohet në një itinerar rreptësisht të përcaktuar. Zbatimi i saj ofron lirinë akademike të mësuesit, për ta zbatuar, zhvilluar dhe përshtatur kurrikulën në kushte specifike.

⁶Vlerësimi i kurrikulës, realizohet me instrumente të cilat masin dhe vlerësojnë përfituesin e kurrikulës: fëmijën parashkollor.

dhe në bashkëpunim me të tjerët, në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve, si dhe të ushtrojnë shkathtësitë për mendim të pavarur dhe kritik.

Vlerësimi i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç matet dhe vlerësohet me instrumente të cilat përmendën më hollësisht tek kapitulli i vlerësimit. Fëmijët që ndjekin arsimin parashkollor motivohen të zhvillojnë përgjegjësinë për veten e tyre, për të tjerët dhe për mjedisin, në kontekst të vetëndërgjegjësimit për pasojat e veprimeve vetjake, si dhe për rëndësinë dhe përgjegjësinë për ndërmarrjen e nismave. Ata përkrahen të zhvillojnë vetëbesimin dhe motivimin pozitiv, të shfrytëzojnë të drejtat që kanë, të kultivojnë kërshtërinë e tyre, si dhe qëndrimin pozitiv ndaj diversitetit, në kuptim të ideve, dukurive, personave, kulturave etj.

2.3 Parimet e përgjithshme që orientojnë zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës

Korniza Kurrikulare rregullon sistemin e arsimit parashkollor. Funksionimi cilësor i këtij sistemi arrihet nëpërmjet respektimit të disa parimeve të përgjithshme. Parimet e mëposhtme janë referenca kryesore për hartimin e të gjitha dokumenteve që rrjedhin nga Korniza Kurrikulare.

2.3.1 Kurrikula e gjerë me bazë kompetencash

Kurrikula e gjerë, është harmonizim dinamik i kurrikulës së planifikuar, që shtjellohet në dokumentet e shkruara zyrtare, të kurrikulës së zbatuar dhe të kurrikulës së përvetësuar.

Kurrikula e konceptuar në këtë mënyrë përfshin përmbajtjen mësimore, mjedisin e të nxënësve, metodat e mësimdhënies, burimet e të nxënësve dhe mënyrat e shumta të bashkëveprimit ndërmjet fëmijëve, mësuesve, prindërve, me qëllim përmbushjen e treguesve të Standardeve të Zhvillimit dhe të të Nxënësve. E konceptuar në këtë pikëprerje të kurrikulës zyrtare me kurrikulën e zbatuar dhe me kurrikulën e përvetësuar, garantohet cilësia e dokumentit si procedurë dhe si fakt.

Nga ana tjetër, kërkohet të mirëstudohen kushtet në të cilat përmbushet kjo kurrikulë dhe kompetenca profesionale e stafëve. Kompetenca, si koncept teorik, shprehet

nëpërmjet përdorimit të njohurive, të shkathtësive, të vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave dhe të kontekstit, duke iu referuar objektivit mësimor dhe individualitetit të të nxënit.

E thënë me fjalë të tjera, kompetenca është ndërthurja e dijeve, e aftësive, e qëndrimeve, e vlerave që u nevojiten fëmijëve për zhvillimin vetjak, qytetarinë aktive, përfshirjen shoqërore dhe punësimin në të ardhmen.

Përcaktimi i kompetencave kyçe, të shprehura me rezultate konkrete të të nxënit, si dhe përcaktimi i kritereve për vlerësimin e zhvillimit dhe të arritjeve, sigurojnë kushtet për mundësi të barabarta për formim cilësor të fëmijëve. Kurrikula e re mundëson fleksibilitet për mësuesin në planifikimin e përvojave të të mësuarit të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e fëmijëve të kësaj moshe.

2.3.2 Baraspesha dhe integrimi si parim

Kurrikula organizohet në fusha të nxëni, të cilat kanë në themel ndarjen, por edhe integrimin real të fushave të dijes. Si e tillë, kurrikula siguron njëherësh baraspeshën ndërmjet njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të secilës fushë të nxëni, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre, në organizimin e saj vertikal dhe horizontal. Shkalla, thellësia dhe forma e integritit, kushtëzohen nga veçoritë e fushave dhe temave të nevojshme për t'u integruar. Integrimi është proces dinamik, që varet nga nevojat për ndryshim në përvetësimin e njohurive, të shkathtësive, si dhe nga situatat e të nxënit.

2.3.3 Vijimësia si parim

Nxënësit zhvillohen dhe nxënë me ritme dhe mënyra të ndryshme, duke i ndërtuar njohuritë e tyre mbi bazën e njohurive dhe përvojës së tyre të mëparshme. Për këtë arsye, kurrikula hartohet dhe zbatohet në harmoni me veçoritë kryesore të grupmoshave dhe në varësi të mundësive dhe të gatishmërisë së fëmijëve për të nxënë. Në të njëjtën kohë, kurrikula i qartëson nxënësit dhe prindërit e tyre për drejtimin, nivelin dhe pikëmbërritjet e të nxënit në shkallë dhe nivele të ndryshme arsimore, të cilat janë bazë për nivelet dhe shkallët pasardhëse.

2.3.4 Gjithëpërfshirja si parim

Kurrikula merr në konsideratë, njeh, pranon, respekton dhe u përgjigjet nevojave, përvojave, interesave arsimore dhe vlerave të të gjithë grupeve të fëmijëve, pavarësisht prejardhjes ose veçorive të zhvillimit psiko-motor e socio-kulturor. Ky parim, garanton një kurrikul që krijon mundësi të barabarta për sukses të çdo fëmije. E udhëhequr nga ky parim, kurrikula ofron zgjidhje që mbajnë parasysh nevojat vetjake dhe mundësitë e të nxënit, si kusht për përmirësimin e nivelit të arritjeve të tyre.

Të gjithë fëmijëve u jepet mundësia të zhvillojnë potencialin e tyre, pavarësisht gjinisë, nivelit social-ekonomik, besimit fetar, racës, grupit etnik ose aftësive të tyre fizike dhe mendore. Çdo fëmijë, është individualitet i papërsëritshëm, përcjell sjellje, mendime dhe nevoja unike.

Fëmijët parashkollorë ndihmohen dhe qartësohen që të ndihen mirë me identitetin e tyre, duke përfshirë gjininë, prejardhjen etnike, racën, aftësitë fizike etj. Kurrikula mbështet fëmijët parashkollorë të kuptojnë cilët janë, si të sillen, si të ndiejnë dhe t'i vlerësojnë gjërat në mënyra të caktuara. Kurrikula, ngulmon që fëmijët parashkollorë të fitojnë besim më të madh te vetja, nisur nga perspektiva e ndryshimeve dhe e ngjashmërive.

2.3.5 Respekti për të ndryshmen si parim

Respektimi dhe pranimi i kulturës së tjetrit është thelbësor për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës. Kurrikula e drejton fëmijën parashkollor drejt ndjenjës së përkatësisë, historisë vetjake, kush është dhe prej nga vjen.

Kurrikula mban në vëmendje elemente të tillë, si struktura e familjes, zakonet, rregullat, marrëdhëniet ndërpersonale, përvojat e fituara, besimet fetare, aspektet e komunikimit verbal dhe jo verbal. Ky parim, sjell në vëmendje zhvillimin e plotë dhe harmonik të çdo fëmije dhe vlerëson ndryshimet individuale ndërmjet tyre.

2.3.6 Qasja ndaj besimeve si parim

Fëmijët parashkollorë, janë të ndjeshëm ndaj diversitetit fetar, gjë që shfaqet jo rrallë tek fëmijët 5 vjeçarë, kur rreken të përshkruajnë përkatësinë fetare. Kurrikula krijon fleksibilitet dhe frymë laike⁷ ndaj sjelljeve që fëmijët parashkollorë mund të përcjellin në një rast të caktuar. Toleranca, bashkëjetesa paqësore, që vijnë nga familje me besime të ndryshme, është detyrim qytetar e profesional, detyrim akademik, që rrjedh nga fryma e kurrikulës, por edhe detyrim për stafet që përcjellin mësim në këtë cikël edukimi.

Fleksibiliteti i kurrikulës, shoqëruar me fleksibilitetin e stafit mësimor i ndihmon fëmijët parashkollorë të shfaqin respekt dhe konsideratë për mënyrën e jetesës dhe sistemin e besimit të dikujt tjetër.

2.3.7 Barazia gjinore si parim

Midis moshës 3-6 vjeç, fëmijët ndajnë perceptimin e tyre për gjininë. Fëmijët parashkollorë për të identifikuar gjininë së cilës i përkasin përdorin karakteristikat e jashtme nisur nga emri; modeli dhe gjatësia e flokëve; veshjet; lodrat; lojërat; personazhet etj. Kurrikula, qëllimshëm, e drejton të nxënësit përtej stereotipisë dhe dallimit gjinor. Ajo i adresohet hartuesit të kurrikulës dhe mësuesit, të cilët i ndihmojnë fëmijët të lëvizin nga stereotipi i rolit gjinor drejt barazisë gjinore, në mënyrë që ata të ndihen të rëndësishëm, të respektuar dhe të barabartë mes njëri-tjetrit. Fëmijët parashkollorë kanë nevojë të besojnë se vajzat dhe djemtë mund t'i realizojnë të gjitha veprimtaritë që ofrohen në një program edukimi. Kurrikula ofron procedura metodologjike edukimi, ku fëmijët përfshihen në grupe të përziera për nga gjinia me qëllim “zbehjen” e diferencave gjinore. Kurrikula formulon pritshmëri të të nxënësve përtej çdo lloji diference gjinore.

2.3.8 Bashkëpunimi dhe partneriteti si parim

Arsimi është përgjegjësi e përbashkët e mësuesve, e prindërve, e specialistëve të arsimit dhe e gjithë shoqërisë. Për këtë arsye, planifikimi, hartimi, zbatimi i kurrikulës dhe, mbi të gjitha, arritja e rezultateve të të nxënësve, kërkojnë bashkëpunim të përgjegjshëm të të gjithë aktorëve dhe palëve të interesuara.

⁷ Në frymën e Kushtetutës.

2.3.9 Autonomia dhe fleksibiliteti si parim

Autonomia dhe fleksibiliteti për zbatimin e kurrikulës në sistemin parashkollor, ka të bëjë me mundësinë dhe përgjegjësinë që ndërmerr dhe përmbush vetë institucioni, për:

- përshtatjen e kurrikulës me nevojat e larmishme të fëmijëve, duke mundësuar edhe individualizimin e veprimtarisë mësimore-edukative;
- krijimin e mundësive për tema të veçanta, të përshtatshme dhe të pëlqyeshme për grupe të caktuara fëmijësh;
- krijimin e hapësirave për tema që lidhen me arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- përfshirjen aktive të mësuesve të arsimit parashkollor në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të përvojave të mësimdhënies, duke rritur përgjegjësinë e tyre për arritjet e fëmijëve;

2.4 Standardet e Zhvillimit dhe të Nxënit të fëmijërisë së hershme

Standardet konsiderohen pjesë e paketës kurrikulare. Ato kanë funksion të shumëfishtë dhe shërbejnë njëherësh, si: instrumente vlerësimi, si pikënisje për të prodhuar kurrikulën, si pikë referimi për të prodhuar paketa trajnimi për stafet pedagogjike, prindërit dhe grupe të tjera interesi.

Standardet përshkruajnë sjelljet, aftësitë dhe njohuritë që mundet dhe duhet të tregojnë fëmijët parashkollorë referuar grupmoshës së tyre. Standardet, përcaktojnë çfarë mund dhe janë në gjendje të demostrojnë fëmijët gjatë rritjes, zhvillimit dhe kalimit nga njëra grupmoshë në tjetrën.

Standardet e Zhvillimit dhe të Nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç u përkasin këtyre fushave të zhvillimit:

- Shëndeti, mirëqenia fizike dhe zhvillimi motorik;
- Zhvillimi social dhe emocional;
- Zhvillimi gjuhësor, leximi dhe shkrimi;
- Zhvillimi njohës dhe njohuri të përgjithshme;
- Përjasjet ndaj të nxënit.

Fëmija zhvillohet në tërësi, ndaj mbivlerësimi apo nënvlerësimi i cilësdo fushë zhvillimore është i gabuar, sepse fëmija nuk zhvillohet në mënyrë të fragmentuar. Prandaj, edhe ndarja mes fushave në dokumentin e standardeve është kryesisht formale, pasi, ashtu si zhvillimi i fëmijës është tërësor, edhe fushat e veçanta të zhvillimit duhet të shikohen si pjesë e një të tërë, efikasiteti i të cilave varet kryesisht nga niveli i integritit me njëra -tjetrën.

Standardet janë dokumente që vihen në përmbushje të qëllimit të kurrikulës së arsimit parashkollor. Standardet fokusohen në çështjet që vijojnë:

- Identiteti vetjak, kombëtar dhe i përkatësisë kulturore;
- Vlerat e përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- Zhvillimi i aspekteve intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- Zhvillimi i përgjegjësive ndaj vetes, të tjerëve, shoqërisë, mjedisit;
- Aftësimi për jetë dhe punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- Aftësimi për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Zhvillimi i shpirtit të sipërmarrjes;
- Përdorimi i teknologjive të reja.

2.5 Kompetencat për nxënien gjatë gjithë jetës

Koncepti “shoqëri e hapur” dhe “globalizëm” shoqëruar dhe me zhvillimin intensiv të teknologjisë, ka theksuar nevojën për zhvillim kompetencash që sigurojnë të nxënë të vazhdueshëm. Referuar qëllimit të arsimit parauniversitar, pjesë e të cilit është arsimit parashkollor, kompetenca kyçe konsiderohen:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
- Kompetenca e të menduarit;
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;
- Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
- Kompetenca personale (vetjake);
- Kompetenca qytetare;
- Kompetenca digjitale.

| 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit | |
|--|---|
| <i>Fëmija parashkollor përgatitet të komunikojë në mënyrë efektive.</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Dëgjon dhe merr informacion për botën që e rrethon. - Tregon aftësi në rritje, për të dëgjuar kur flasin të rriturit, bashkëmoshatarët ose fëmijët më të vegjël. - Komunikon në gjuhën amtare, drejtshqipton tingujt, shkronjat dhe fjalët më të përdorshme. - Shprehet me anë të simboleve, kodeve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. - Shpreh tolerancë dhe empati në komunikim. - Ua komunikon mendimet, ndjenjat apo ngjarjet që përjeton, të rriturve dhe fëmijëve të tjerë. - Shpreh mendimin e vet, <i>ku</i> dhe <i>kur</i> duhet etj. |
| 2. Kompetenca e të menduarit | |
| <i>Fëmija parashkollor zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgon, krahason dhe vlerëson ngjarje dhe veprime. - Zgjidh situata të thjeshta problemore. - Kërkon zgjidhje të shumëfishta për detyrat dhe problemet. - Përdor simbole për të paraqitur objekte. - Vlerëson dhe vetëvlerësohet. - Krijon dhe "shpik" gjëra të reja. - Mendohet para se të bëjë një punë a një detyrë. - Zbulon lidhjet mes shkakut dhe pasojës. - Kërkon ndihmë, kur ka nevojë. - Mbron mendimin e vet. |
| 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë | |
| <i>Fëmija parashkollor përgatitet për të nxënë gjatë gjithë jetës</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Tregon interes për të nxënë. - Shfaq interes për të përjetuar përvoja të reja. - Merr nisma në bashkëveprim me të tjerët. - Tregon këmbëngulje për të marrë pjesë në veprimtari edhe nëse gjatë zhvillimit të tyre përballet me vështirësi. - Përdor aftësitë krijuese dhe fantazinë në veprimtaritë e jetës së përditshme. - Mëson nga përvojat vetjake dhe i përdor njohuritë e fituara në situata të reja. - Mëson dhe shkëmben përvoja pozitive në grup, merr dhe mban përgjegjësi. - Siguron mjetet, materialet dhe kohën para se të kryejë një detyrë. - Përfundon një punë të nisur. - Rishikon punët që bën, korrigjon gabimet dhe i përmirëson ato. |

| 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin | |
|---|--|
| <i>Fëmija parashkollor orientohet drejt së ardhmes dhe nxitet të përmbushë objektivat që i vë vetes.</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Paraqet mirë vetveten, duke vënë theksin në pikat e forta. - Punon në mënyrë të pavarur dhe në grup. - Organizon dhe udhëheq veprimtari të nxëni dhe shoqërore. - Merr pjesë në mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit. - Diskuton me të tjerët për mjedisin që e rrethon. - Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna. |
| 5. Kompetenca personale (vetjake) | |
| <i>Fëmija parashkollor bën jetë të shëndetshme, përfshihet në mënyrë efektive në jetën familjare dhe shoqërore.</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Mban dhe zhvillon qëndrim pozitiv për veten, kupton se është unik dhe ndihet krenar për arritjet e tij. - Shpreh dhe menaxhon në mënyrën e duhur sjelljen dhe emocionet. - Shfaq aftësi vetëkontrolli në punë individuale dhe në grup. - Shfaq vetëbesim gjatë veprimtarive të ndryshme. - Ndihmon dhe shfaq empati për të tjerët. - Bën zgjedhje të përgjegjshme për shëndetin vetjak. - Mendohet para se të veprojë. - Parashikon pasojat e një sjelljeje të caktuar. - Respekton punën e vet dhe të të tjerëve. |
| 6. Kompetenca qytetare | |
| <i>Fëmija parashkollor përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët dhe përgatitet të veprojë si qytetar i përgjegjshëm.</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Demonstron njohuri për komunitetin, ndërvarësinë midis njerëzve, roleve të ndryshme sociale dhe përgjegjësinë qytetare. - Kupton rolet në familje dhe përgjegjësitë e anëtarëve të saj. - Ndërvepron lehtësisht me të rriturit që njeh. - Bashkëpunon me bashkëmoshatarët. - Kupton sjellje të ndryshme dhe ndikimin e tyre (pozitiv dhe negativ). - Përshtatet në mjedise të ndryshme. - Shfaq empati përkundrejt të tjerëve. - Mirëkupton dhe respekton dallimet ndërmjet njerëzve. - Pranon të tjerët. |
| 7. Kompetenca digjitale | |
| <i>Fëmija parashkollor fiton shkathtësitë e para të përdorimit të kompjuterit, për ta përdorur atë për qëllime personale.</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Përdor në mënyrë të përshtatshme disa pajisje teknologjike dhe tregon ndikimin e tyre në jetën e përditshme. - Realizon vetë vizatime dhe punime të thjeshta në kompjuter. |

KAPITULLI III

TEORITË MBI ZHVILLIMIN E FËMIJËS

PIKËNISJE PËR KURRIKULËN

TEORITË MBI ZHVILLIMIN E FËMIJËS – PIKËNISJE PËR KURRIKULËN

3.1 Fakte të konfirmuara: Nevojat e fëmijëve nga 3-6 vjeç

Fëmijët e kësaj grupmoshe kanë nevoja dhe dëshira të përafërta me njëri-tjetrin. Çdo fëmijë parashkollor ka nevojë të marrë besimin dhe sigurinë e nevojshme nga të rriturit. Çdo fëmijë priret të ndërthurë veprimtari të ndryshme fizike, krijuese, sjellore; ka nevojë të vetëshfaqet tek të rriturit.

3.1.1 Nevoja për besim dhe siguri si fakt i konfirmuar

Fëmijët kanë nevojë të zhvillojnë ndjenjën e besimit në vetvete. Nëse ndihen të sigurtë në një mjedis që është i përshtatshëm dhe mbështetës, ata do të *guxojnë* të eksplorojnë se çfarë mund të bëhen; do të guxojnë të bëjnë gabime dhe të mësojnë të pranojnë pasojat. Fëmija parashkollor, i ndjerë në siguri, mëson t’u përshtatet situatave të reja dhe të shkëmbejë ide, duke ruajtur individualitetin e vet. Pasiguria krijon mungesën e qetësisë dhe prek ritmin e zhvillimit.

3.1.2 Nevoja për dashuri si fakt i konfirmuar⁸

Fëmijët, priren ta kërkojnë, ta gjejnë dashurinë përreth dhe instiktivisht priren drejt saj. Dashuria frekvente e qëllimtë, por jo e përkthyer në “llastim”, i jep fëmijës sigurinë. Kjo klimë, ndihmon në menaxhimin e kurbës së emocioneve të fëmijës.

3.1.3 Nevoja për kohën e duhur në lojë si fakt i konfirmuar

Raporti i fëmijës me lojën është i gjithëpranuar. Koha, në funksion të lojës, është relativisht e pamatshme. Çdo fëmijë është unik në raport me lojën. Ndërkohë që fëmijët shijojnë lojën dhe veprimtaritë që zhvillojnë me të tjerët, ndiejnë vazhdimish nevojën për të patur një hapësirë të tyre, për të luajtur qetësisht ose ëndërrojnë për atë që u pëlqen.

⁸ Dashuria të mëson të sillesh – sentencë e konfirmuar

3.1.4 Nevoja për të qenë i pavarur si fakt që duhet menaxhuar

Fëmijët dallohen për një lloj “padurimi” për të qenë të rritur. Kjo dëshirë lidhet me nevojën për të qenë të pavarur. Ata priren të jenë gjithmonë e më pak të varur nga të rriturit, dëshirojnë të marrin nisma, të mbajnë parasysh interesat dhe parapëlqimet vetjake.

3.1.5 Nevoja për eksplorim, vëzhgim

Fëmijët kanë nevojë të luajnë dhe të eksplorojnë, sepse kjo është mënyra nëpërmjet së cilës njohin dhe kuptojnë botën rreth tyre. Po kështu, priren të gjejnë mundësinë për të përshkruar atë që shohin dhe bëjnë, të zgjidhin probleme dhe të vlerësojnë atë që shohin dhe dëgjojnë; kanë nevojë të eksperimentojnë, të zbulojnë dhe të veprojnë me materialet që kanë para; kanë nevojë të bëhen vëzhgues të kujdesshëm, të reflektojnë në vëzhgimet e kryera, të nxiten prej tyre për zhvillimin e njohurive, të vlerave, shprehive dhe proceseve, që i çojnë drejt të nxënimit të pavarur.

Hapja ndaj botës. Fëmijët janë të paduruar për të zbuluar mjedisin që i rrethon. Ndjenja e habisë dhe kureshtja natyrale i motivon fëmijët për të vepruar dhe për t'i zbuluar vetë gjërat. Veprimtaritë e kopshtarisë, të vëzhgimit të motit, lojërat e ujit, manipulimi me objekte të ndryshme, vëzhgimi i pikturave dhe i fotografive, janë veprimtari që ndihmojnë fëmijët ta plotësojnë këtë nevojë.

3.1.6 Nevoja për veprimtari fizike si fakt i konfirmuar

Zhvillimi fizik realizohet nëpërmjet veprimtarive fizike, duke eksploruar hapësira dhe mbajtur objekte të ndryshme. Shkallë-shkallë, fëmijët bëhen të ndërgjegjshëm për trupin e tyre dhe fitojnë aftësi për të zotëruar dhe kontrolluar lëvizjet e ndryshme, nëpërmjet veprimtarive të tilla, si: vrapimi, kërcimi, hedhja, prerja, vizatimi dhe shkuarja e rruazave në një fill. Vlerësimi për veten është i lidhur ngushtë me ndjenjat e tyre për trupin dhe aftësitë për të pranuar veçoritë fizike që ata kanë.

3.1.7 Nevoja të shkëmbejnë përvojat me bashkëmoshatarët dhe të rriturit

Fëmijët kanë nevojë të ndihen se janë pjesë e komunitetit; kanë nevojë të flasin dhe të dëgjojnë fëmijë të tjerë dhe të rritur; kanë nevojë të shohin se çfarë bëjnë të tjerët dhe të imitojnë veprimet e tyre; kanë nevojë të provojnë lloje të ndryshme marrëdhëniesh me të tjerët. Fëmijët, kanë nevojë të mësojnë se njerëzit e tjerë nuk mendojnë dhe nuk i shohin gjërat në të njëjtën mënyrë si ata; kanë nevojë të luajnë role të ndryshme, të marrin dhe të ndajnë lodrat e materialet me të tjerët.

3.1.8 Nevoja për të njohur veten - fakt i konfirmuar

Raporti i parë i fëmijës me veten nis nëpërmjet marrëdhënies që ai vendos me emrin. Si reagon me emrin e vet, çfarë di për të, si përgjigjet kur i bëjnë pyetje rreth emrit etj., identifikimi që i bën vetes me fëmijët që kanë të njëjtin emër ose mosdëshira për ta artikuluar emrin e vet.

3.2 Teoritë zhvillimore të rritjes dhe teoritë zhvillimore të të nxënimit

Përfaqësuesit më në zë të teorive zhvillimore të rritjes dhe të të nxënimit janë: Erikson, Maslow, John Dewey, Vigotsky, Piazhe, Bronfenbrenner.

Secila nga këto teori ka pikat e forta dhe të dobëta, në varësi të kohës dhe të kontekstit socio-kulturor në të cilat ato janë zhvilluar. Duke iu përmbajtur qëllimit kryesor të Kornizës Kurrikulare të arsimit parashkollor, në vijim, trajtohen teoritë kryesore që lidhen ngushtë me stadet e zhvillimit e të të nxënimit të fëmijëve të kësaj moshe.

3.2.1 Teoria zhvillimore Erikson

Erik Erikson (1902-1994). Në veprën e tij “Fëmijëria dhe shoqëria” (1963) Erikson jep karakteristikat themelore të zhvillimit të personalitetit të individit. Erikson thekson zhvillimin e personalitetit në parimin epigjenetik. Në zhvillimin e fetusit, organe të caktuara të trupit shfaqen në kohë të përcaktuara, që realisht “kombinohen” për të krijuar një fëmijë. Erikson, ngre hipotezën se ashtu si pjesët e trupit zhvillohen në mënyra të ndërlidhura në një fetus njerëzor, po ashtu, dhe personaliteti i një individi formohet përmes një sërë fazash të ndërlidhura. Ajo çka kuptohet qartë është që individi e zhvillon konceptin e identitetit të tij duke qenë në ndërveprim me të tjerët.

Erikson e analizon teorinë e zhvillimit psikosocial në 8 faza. Në çdo fazë, individi përballet me një sfidë. Nëse sfidat nuk zgjidhen, individët hasin konflikte në jetën e mëvonshme.

Stadet e zhvillimit sipas Erikson

| Stadet dhe mosha | Shpjegimi | Detyra | Zgjidhja |
|--|--|---------------------------------|------------|
| Stadi i parë: Besimi kundrejt mosbesimit (0 - 18 muaj). | Besim kundrejt mosbesimit. Gjatë vitit të parë të jetës, te foshnjat duhet zhvilluar ndjenja e besimit. Ato varen plotësisht nga të tjerët dhe shpresohet që të rriturit t'i ndihmojnë dhe jo t'i dëmtojnë. Nëse foshnjat duhen prej të rriturve, tek këto do zhvillohet besimi për të ardhmen. Nëse jeta e tyre është e pasigurt, do të zhvillohet frika dhe mosbesimi ndaj të tjerëve. | Fitimi i sigurisë dhe i besimit | Shpresa |
| Stadi i dytë: Autonomia kundrejt dyshimit (18 muaj - 3 vjeç). | Fëmijët kanë mundësi të formojnë një ndjenjë autonomie, të kuptojnë në një farë mase se kanë lirinë dhe aftësinë për të bërë disa veprime në mënyrë të pavarur prej njerëzve përreth. Nëse të tjerët përreth janë kritikues, fëmijët mund të krijojnë dyshime për pavarësinë e tyre. | Fitimi i pavarësisë | Vullneti |
| Stadi i tretë: Nisiativa kundrejt ndjenjës së fajit | Në "stadin e lojës", fëmijët duhet të formojnë një ndjenjë nismëtare: të bëjnë plane në mënyrë të pavarur të udhëhequr prej vetëdijes së tyre. | Eksplorimi i mjedisit | Pikësynimi |

| | | | |
|---|--|---------------------------------------|------------|
| (3- 6 vjeç). | Nëse prindërit i ndëshkojnë nismat, fëmija mund të formojë ndjenja faji dhe të humbasë besimin tek vetja. | | |
| Stadi i katërt: Të qenit punëtor dhe sistematik kundrejt inferioritetit (6-12 vjeç). | Në shkollë, fëmijët mësojnë, të punojnë fort e në mënyrë sistematike, të jenë kompetentë, të këmbëgulin në veprimtaritë e tyre. Ata mësojnë që janë anëtarë të shoqërisë, që duhet të bashkëpunojnë me të tjerët dhe të kontrollojnë nervozizmin, në sjellje që janë të pranueshme. Tek ata formohet besimi në aftësitë e veta. Nëse fëmijët nuk i kryejnë detyrat që u jepen ose kritikohen shumë, do të përjetojnë një ndjenjë dështimi dhe inferioriteti. | Manipulimi me objekte | Kompetenca |
| Stadi i pestë: Identiteti përkundrejt konfuzionit të roleve (12-18 vjeç). | Ky stad përfshin adoleshencën. Gjatë këtij stadi, adoleshentët ndeshen me problemin e identitetit vetjak, me pyetjen: “Kush jam unë?”. Ata mund të imitojnë të tjerët dhe, nëse sjelljet që imitojnë janë kontradiktore, mund të përjetojnë një “krizë ideniteti” dhe për pasojë, duhet të modifikojnë ose të braktisin imitimet e tyre. Në këtë stad, adoleshentët duhet të vendosin se çfarë duhet të bëjnë në jetë. | Formimi i konceptit pozitiv për veten | Besnikëria |

| | | | |
|---|--|-----------------------------------|------------------------|
| Stadi i gjashtë: Intimiteti kundrejt izolimit - I rrituri i ri (18-40 vjeç). | Problemi themelor i moshës së rritur së hershme është intimiteti. I rrituri, ka si qëllim të krijojë lidhje intime me dikë tjetër dhe zotohet të përkushtohet në këtë marrëdhënie, e cila mund të finalizohet në martesë. | Formimi i marrëdhënive sociale | Dashuria |
| Stadi i shtatë: Produktiviteti - I rrituri mesatar (40-65 vjeç). | Problemi themelor në moshën e rritur të mesme është ai i qëllimeve të stabilizuara, përkushtimeve dhe atashimeve të zgjatura, që bëjnë të mundur një produktivitet të moderuar. I rrituri, shqetësohet për familjen e tij dhe për ndihmesën që do të japë për shoqërinë. | Zhvillimi i shqetësimit për botën | Kujdesi për të tjerët |
| Stadi i tetë: Integriteti kundrejt dëshpërimit I rritur madhor (65 + vjeç). | Në moshën e rritur të vonë dhe në pleqëri, individët duhet të mësojnë ta pranojnë jetën ashtu siç e kanë jetuar; me zhgënjime e gëzime dhe ta përballojnë vdekjen me guxim në këtë stad final. Nëse individët nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë, ata përjetojnë dëshpërim, që buron prej mendimit se nuk janë më të vlefshëm. | Arritje e kënaqësisë personale | Eksperiencia, mënjëria |

Zbatimi i teorisë së Erikson tek fëmijët në stadet e hershme

- Disa tipe sjelljesh dhe marrëdhëniesh, mund të kenë një domethënie të veçantë në stade të ndryshme moshash.
- Nevoja për kujdes të përgjegjshëm nga një numër i vogël njerëzish për stadet e hershme.

- Mbështetja e parashkollorëve nga të rriturit, për të strukturuar veprimtaritë e tyre.
- Krijimi i hapësirave për lojëra dhe eksperimente të lira, për të nxitur zhvillimin e autonomisë të fëmijët nga 3- 6 vjeç.
- Përdorimi i disiplinimit pozitiv, për të ndihmuar fëmijën në ndreqjen e gabimeve.
- Ndërsa fëmijët rriten ata marrin më shumë përgjegjësi për të nxënin e tyre.
- Roli i rëndësishëm që luan mjedisi fizik-social në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve.

3.2.2 Teoria humaniste Maslow

Shumë psikologë e shohin sjelljen njerëzore të motivuar nga disa faktorë. Njëra nga teoritë e motivacionit njerëzor, është teoria humaniste e Maslow-t. Ai theksoi dhe mbrojti tezën se, motivacionin individit duhet ta shohë si një të tërë, duke u bazuar në një hierarki nevojash, të cilat, nëse plotësohen në mënyrë të kënaqshme, bëjnë që njeriu ta realizojë plotësisht potencialin e vet. Teoria e Maslow-t konsiderohet edhe si piramida e nevojave.

(Shih - figurën 1, në ANEX)

| Nevojat | Shpjegimi | Implikimet e teorisë së Masloëë gjatë punës me fëmijët |
|-----------------------------|---|---|
| Nevojat fiziologjike | Nevoja si uria, etja, strehimi etj. Kur plotësohen këto nevoja, individit motivohet për siguri. | Është e rëndësishme që fëmijëve të moshave 3-6 vjeç t'u plotësohen nevojat në mënyrë që ata të motivohen për të kërkuar më shumë. Një fëmijë i uritur, nuk është i motivuar për të nxënë. |
| Nevojat për siguri | Nevoja të tilla, si: qëndrueshmëria, varësia, liria, rregulli, janë kushte | Fëmijëve u pëlqen rutina dhe mjedisi familjar dhe, kur këto gjëra çrregullohen ndjeshëm ata përjetojnë probleme. Kur |

| | | |
|--|---|--|
| | për siguri. Këto nevoja bëhen forca zotëruese të jetës së personit deri në çastin kur ato plotësohen. | individit ndihet i siguruar dhe i parrezikuar, atëherë atij i lindin nevoja të tjera sociale, të cilat janë të një niveli më të lartë. Kopshti, si institucion i rëndësishëm bën fëmijët të ndihen të sigurtë, të lirë për të realizuar nevojat vetjake. |
| Nevojat për përkatësi dhe dashuri | Nevoja për dashuri, afekcion, përkatësi, për miq, për familjen dhe për kontakte shoqërore. | Fëmija, beson se, nëse nuk plotësohen nevojat për përkatësi dhe dashuri, lindin probleme psikologjike. |
| Nevojat për vlerësim | Vlerësimi i lartë i vetes, vetërespekti, suksesi dhe respektimi nga të tjerët, konsiderohen si nevoja për vlerësim. | Në rastet kur fëmija nuk i plotëson nevojat, priret të ndihet inferior dhe i pafuqishëm. Te fëmijët e grupmoshave 3-6 vjeç, vlerësimi në mënyrë pozitive stimulon rritjen e vetëvlerësimit. |
| Vetëpërbushja | Kur nevojat e lartpërmendura janë plotësuar, fëmija është i motivuar për t'u rritur e vetëpërbushur. | Maslow besonte se vetëpërbushja arrihet rrallë dhe, nëse ndodh, arrihet nga njerëz të moshuar, të cilët e kanë patur kohën dhe mundësinë për ta arritur këtë nivel. |

Zbatimi i teorisë së Maslow në mësimdhënie:

- Ndihmon të mësojmë si motivohen fëmijët.
- Programet e fëmijërisë së hershme shkojnë përtej përbushjes së nevojave bazë.
- Asnjë nga nevojat e teorisë së Maslowt nuk është më pak e rëndësishme.
- Vetëpërbushja duhet të vlerësohet në vitet e para të jetës.

3.2.3 Zhvillimi konjitiv i fëmijës sipas Piazhësë

Piazheja studioi sjelljen e fëmijëve nëpërmjet vëzhgimit gjatë kohës së lojës, zgjidhjes së problemeve dhe eksperimenteve. Piazheja, besonte se zhvillimi konjitiv është një mënyrë përshtatjeje ndaj mjedisit dhe, se fëmijët në mënyrë të natyrshme janë të përkushtuar ndaj eksplorimit dhe kuptimit të gjërave. Piazheja, besoi se ka një moshë të përafërt për realizimin e proceseve të caktuara të fëmijët.

Fazat e zhvillimit konjitiv të fëmijët, Piazheja i grupoi në 4 stade:

| Stadet | Shpjegimi |
|--|--|
| <p>1. Stadi sensor-motorik (0-2 vjeç)</p> | <p>Foshnjat nuk shfaqin as të menduarit, as të ndjerit, që lidhet me prezantimet që mundësojnë kufizimin e personave apo të objekteve edhe kur ato nuk janë të pranishme. Foshnjat, e perceptojnë dhe e ndjejnë mjedisin përreth, nëpërmjet shqisave, thithjes dhe kapjes. Ato marrin kënaqësi, duke thithur gjirin e nënës, duke futur gishtin apo objekte të tjera në gojë. Në këtë fazë, zhvillohet edhe vetëdija e foshnjave, që gjërat dhe sendet kanë vazhdimësi, edhe kur ato nuk i kap syri. Për një fëmijë të porsalindur, objektet që zhduken thjesht pushojnë së ekzistuari; por fëmija pasi mësohet me botën, fillon të zhvillojë ndjesinë e vazhdimësisë së objekteve.</p> <p>Në moshën 18-24 muaj, foshnjat fillojnë të përfytyrojnë lëvizjen e një objekti, që në të vërtetë nuk e shohin të lëvizë. Kjo dukuri lidhet me aftësinë e tyre për të formuar imazhe mendore të objekteve, që fillon në fund të kësaj faze të parë dhe ka lidhje me të menduarit apo të kujtuarit e një objekti, personi apo ngjarjeje.</p> <p>Nga fundi i kësaj faze, fillon dhe njohja e vetes, që do të thotë se fëmijët e njohin veten e tyre – dukuria pasqyrë.</p> |
| <p>2. Stadi paraoperacional</p> | <p>Fëmijët hyjnë në fazën paraoperacionale të zhvillimit konjitiv dhe të menduarit e tyre është akoma i lidhur ngushtë me</p> |

| | |
|---|---|
| <p>(2-7 vjeç)</p> | <p>përvojat e tyre fizike dhe perceptuese. Por, shtimi i aftësisë së tyre për të përdorur imazhet mendore krijon shtratin për zhvillimin e gjuhës, duke i përdorur fjalët si simbole, për të paraqitur ngjarjet dhe për të përshkruar, kujtuar dhe arsyetuar mbi përvojat. Të menduarit figurativ krijon shtratin edhe për dy karakteristika të tjera dalluese të kësaj faze-angazhimi në <i>lojërat me fantazi</i> dhe përdorimin e <i>gjesteve simbolike</i>. Fëmijët e kësaj moshe, mbeten ende egocentrikë dhe e kanë të vështirë t'i shohin gjërat nga këndvështrimi i të tjerëve, apo ta vënë veten në vendin e të tjerëve. Ata, gjithashtu, përqendrohen më shumë në aspektin më të dallueshëm të një objekti, duke shpërfillur gjithçka tjetër; nuk mund të mendojnë në të shkuarën dhe as në të ardhmen, pra, fëmijët e kësaj moshe, ende nuk e kuptojnë dot parimin e konservimit, që sendet, objektet, lëngjet, e ruajnë sasinë/përmasat, megjithëse mund të ndryshojnë formën apo dukjen.</p> |
| <p>3. Stadi 3-4 i veprimeve konkrete dhe formale (7 vjeç-adoleshencë).</p> | <p>Gjenden të detajuara në Kornizën Kurrikulare të arsimit parauniversitar.</p> |

Zbatimi i teorisë së Piazhës në mësimdhënie

- Vlerësimi i nivelit të menduarit të çdo fëmije, duke kryer disa nga eksperimentet e Piazhës.
- Të mësuarit nëpërmjet veprimtarisë dhe përvojës së drejtpërdrejtë është thelbësore. Sigurimi i shumë materialeve i krijon mundësi fëmijëve të mësojnë vetë.

- Ndërtimi i situatave për të krijuar ndërveprime sociale, në mënyrë që fëmijët të mësojnë nga njëri-tjetri.
- Planifikimi i përvojave të të mësuarit, duke marrë në konsideratë nivelin e të mësuarit, i përmbushur nga një individ ose grup.

3.2.4 Zhvillimi konjitiv i fëmijës sipas Vigotskit

Teoria e zhvillimit konjitiv të Vigotskit përqendrohet në idetë që ndërveprimi social dhe loja imagjinative janë kontribuesit kryesorë në procesin e zhvillimit konjitiv tek fëmijët. Ai besonte që ndërveprimi social në të cilin përfshihen fëmijët i ndihmon ata të zbulojnë dhe të kuptojnë nga gjërat që zbulojnë.

Fëmija vëzhgon sjelljet e të rriturit edhe ndjek udhëzimet verbale që jepen prej tij. Më pas fëmija kopjon ato që vëzhgon tek i rrituri, përpiqet t'i kuptojë ato që vëzhgon dhe udhëzimet që merr duke kopjuar, brendësuar dhe mësuar si t'i zbatojë në jetën e tij.

Zhvillimi konjitiv sipas Vigotskit kalon në këto stade:

1. niveli fillestar i aftësive;
2. zona e zhvillimit të përafërt;
3. ndihmesa nga të tjerët;
4. asistimi i vetes;
5. brendësimi;
6. automatizimi.

Vigotski identifikon dy rrugë për *zhvillimin konjitiv*: *proceset biologjike* dhe *proceset psikologjike (social-kulturore)*. Sipas Vigotskit, elementët që kanë ndikim në zhvillimin konjitiv janë zhvillimi gjuhësor dhe marrëdhëniet sociale ⁹. Në zhvillimin konjitiv këto procese shfaqen në planin interpsikologjik (shkëmbimet sociale më të tjerët) dhe infra-psikologjik (të folurit të brendshëm për të drejtuar sjelljen).¹⁰

Sipas Vigotskit, fëmijët e moshës parashkollore përdorin shpesh atë, që ai e quan, të folurit me vete, kur ata po përpiqen të kryejnë një detyrë në “zonën e tyre të përafërt të

⁹ Vygotsky, Lev. *Mind in Society: The Development of Higher Psychological Processes* (Harvard Univ. Press), 1978.

¹⁰ Po aty.

zhvillimit“, me ndihmën e një personi tjetër të rritur. Ajo që fëmijët kuptojnë, shfaqet fillimisht në të folurit me veten, e më pas brendësohet si mendim.

Zhvillimi i gjuhës

Vigotski ishte veçanërisht i interesuar në rolin e gjuhës në zhvillimin konjitiv. Duke qenë se gjuha është jetësore në ndërveprimet njerëzore, ai besonte që gjuha është mjete më i rëndësishëm që njerëzit mund të përdorin. Vygotski besonte që ka tre forma të foluri, që janë përshkruar më poshtë:

- **Të folurit social** – referohet si komunikimi i jashtëm, që ndodh kur njerëzit e përdorin gjuhën për të folur me të tjerët. Vigotski besonte që ky lloj të foluri ishte tipik tek fëmijët në moshën 2 vjeçare.
- **Të folurit personal** – referohet si komunikimi i brendshëm, që një individ e drejton ndaj vetes. Kjo shërben si një funksion intelektual dhe është tipik tek fëmijët e moshës mbi 3 vjeç.
- **Të folurit e heshtur, i brendshëm** – kur të folurit personal dobësohet nga ana auditive, bëhet një funksion vetërregullues. Vigotski besonte që kjo ishte tipike tek fëmijët e moshës nga 7 vjeç.

Për Vygotskin, e folura personale është një moment shumë i rëndësishëm në zhvillimin konjitiv të fëmijës ku mendimet lidhen me fjalët dhe fëmija fillon të shfaqë të menduarit verbal. Aftësia për të etiketuar objekte dhe procese është e nevojshme për zhvillimin konceptual, përgjithësimin dhe mendimin. Aftësia e fëmijëve në moshën parashkollore për përdorimin e gjuhës gjatë mendimit është zhvillimi kyç i kësaj periudhe, i cili bën të mundur që fëmijët të zgjidhin probleme të reja pa u mbështetur vetëm tek prova dhe gabimi.

Zbatimi i teorisë së Vigotskit në mësimdhënie

Zbatimi më i rëndësishëm nga teoria e Vygotskit janë konceptet e tij për zonën e zhvillimit të përafërt. Koncepti i Vygotskit për zhvillimin e afërt është bazuar në idenë që, zhvillimi i fëmijës përcaktohet nga *çfarë bën fëmija në mënyrë të pavarur, çfarë bën fëmija i ndihmuar nga një i rritur apo bashkëmoshatar më i aftë.*

Njohja e dy niveleve të zonës së Vygotsky janë të nevojshme për mësuesit, duke qenë se këto nivele tregojnë se ku fëmija ndodhet në një moment të caktuar, si edhe ku është duke shkuar. Zona e zhvillimit të afërt ka përfshirje të ndryshme në mësimdhënien në klasë. Vygotski beson se fëmija zhvillohet në mënyrë të përshtatshme, kur mësuesi planifikon aktivitete që përfshijnë jo vetëm ato çfarë fëmijët mund të bëjnë individualisht, por çfarë mund të bëjnë me ndihmën e të tjerëve.

3.2.5 Teoria e zhvillimit ekologjik të fëmijës - sipas Urie Bronfenbrenner

Urie Bronfenbrenner kërkimet i bëri në hapësirën natyrale të familjes së tyre, të shkollës, grupit të bashkëmoshatarëve dhe komunitetit. Kërkimet e shumta të Bronfenbrenner-it theksojnë fuqinë që kanë lidhjet njerëzore. Urie Bronfenbrenner njihet si psikolog fëmijësh, autor, bashkëautor por më e rëndësishmja dhe ajo që e bëri të njihet në gjithë botë autorin ishte krijimi *i Teorisë ekologjike të zhvillimit njerëzor*.

Një nga besimet e tij në terma shkencore është se lidhjet me fëmijën janë fuqia më e madhe në zhvillimin e fëmijës. Ai gjithashtu pohon se nëse fëmija nuk ka një lidhje të veçantë me një të rritur dhe i mungon ndjenja e përkatësisë ai nuk mund të zhvillohet normalisht dhe si rrjedhojë nuk mund të arrijë potencialin e vet.

Sipas Bronfenbrenner-it *që një fëmijë të zhvillohet nga ana intelektuale, emocionale, sociale dhe morale, duhet të marrë pjesë në aktivitete të rregullta, të përditshme me një apo më shumë persona me të cilët fëmija krijon lidhje të fortë emocionale*. Sipas autorit mjedisi ekologjik është paraqitur si një sërë strukturash bashkëqendrore të cilat janë të vendosura njëra mbi tjetrën dhe që përkufizohen si: *mikrosistem, mezosistem, ekzosistem, makrosistem dhe kronosistem*.

Mikrosistemi

Cilësohet si mjedisi më i afërt në të cilin fëmija jeton, ndërton marrëdhënie ndërpersonale dhe karakterizohet nga një eksperiencë sociale direkte. Këtu përfshihen familja e fëmijës, bashkëmoshatarët, komshinjtë dhe njerëzit që kanë kontakt të drejtpërdrejtë, sistematik, të qëllimshëm dhe të vazhdueshëm me të.

Mezosistemi

Përfshin të gjithë marrëdhëniet ndërmjet mikrosistemeve në jetën e fëmijës. Këtu mund të përmendim lidhjen që kanë prindërit e fëmijës me kopshtin.

Ekzosistemi

Përfshin të gjitha situatat që nuk ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e fëmijës, por ndryshimet që ndodhin në mjedis mund të ndikojnë në jetën e tij/saj. Këtu mund të përmendim miqtë e prindërve, shokët e klasës të vëllait ose të motrës, ose dinamikat familjare të mësuesve, puna e prindërve etj.

Makrosistemi

Eshtë i determinuar nga pikëprerjet e mikrosistemit, mezosistemit dhe ekzosistemit, të cilat zhvillohen në kontekstin sociokulturor të caktuar dhe marrin karakteristikat e kulturës ose të nënkulturës. Këtu mund të përmendim skemat e besimit, stilet e jetës në të cilat janë krijuar dhe organizuar situata të ndryshme mjedisore brenda një kulture ose brenda një grupi social-ekonomik, etnik ose religjioz.

Kronosistemi

Përfshin të gjitha tranzicionet që një individ kalon në jetën e tij. Këtu përfshihen kontekstet social-historike që ndikojnë në jetën e një individi. Një shembull klasik mund të jetë divorci i prindërve, ndarja e të cilësve ndikon në jetën e çiftit, por edhe në jetën dhe sjelljen e fëmijës. Pra zhvillimi i fëmijës është rezultat jo vetëm i veprimtarive që zhvillon dhe i marrëdhënieve që krijon me njerëzit që kujdesen për të, por ndikohet edhe nga faktorë të jashtëm, si: situata e punës së prindërve të tyre, mbështetja që prindërit i japin gjatë detyrave të tyre si prindër, cilësia e shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijëve, cilësia e shërbimeve sociale për fëmijën, politikat lidhur me fëmijërinë dhe familjen etj.

Bazuar tek teoritë e zhvillimit dhe të të nxënimit të fëmijëve, **kurrikula e arsimit parashkollor e vendos theksin në njohuritë, aftësitë, sjelljet dhe vlerat** që fitohen dhe

zhvillohen gjatë viteve të fëmijërisë së hershme. Treguesit e standardeve të zhvillimit dhe të të nxënit, arrihen nëpërmjet zbatimit të kurrikulës e cila për tri vitet e arsimit parashkollor bën të mundur që fëmija:

- Të shoqërizohet me familjen, shokët, mësuesit dhe të rriturit e tjerë;
- Të pranojë të tjerët dhe të jetojnë së bashku pavarësisht gjinisë, etnisë, moshës dhe aftësive;
- Të përshtatet dhe të shijojë përvojat e lidhura me ndryshimin, surprizat dhe pasigurinë;
- Të kuptojë drejtësinë në lidhje me veten e tij dhe të tjerët;
- Të marrë pjesë në krijimin, ndjekjen dhe ripunimin e rregullave që sigurojnë mbarëvajtjen e procesit;
- Të komunikojë mendimet dhe përvojat në mënyrë krijuese, duke përdorur disa forma të të shprehurit.
- Të zhvillojë koordinimin fizik dhe sjelljen e shëndetshme.

KAPITULLI IV

METODOLOGJITË E TË NXËNIT REFERUAR KURRIKULËS NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

METODOLOGJITË E TË NXËNIT REFERUAR KURRIKULËS NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

4.1 Mësimdhënia dhe të nxëniet në Arsimin parashkollor

Është e vështirë të japësh një përkufizim të vetëm se çfarë është të nxëniet në parashkollor, kur, ku dhe si zhvillohet ai. Fëmijët mësojnë gjatë gjithë kohës. Nëse do t'i referohemi periudhës kur një foshnjë fillon të hedhë hapat e para, kujtojmë si mbahej ai pas një karrigeje ose një objekti tjetër, derisa mësoi të ecë vetë, në mënyrë të pavarur.

Institucioni parashkollor zë një vend të veçantë në formimin harmonik të personalitetit të fëmijëve 3-6 vjeç. Veprimtaria edukative e kopshtit si plotësuese e veprimtarisë familjare dhe parapërgatitore për shkollën fillore, përbën një përvojë të rëndësishme që ndihmon fëmijën të rritet. Ajo ka për qëllim:

- formimin e gjithanshëm të individit të lirë, të përgjegjshëm dhe pjesëmarrës në jetën shoqërore;
- përvetësimin e aftësive dhe kompetencave komunikuese, shprehëse, logjike dhe vepruese;
- zhvillimin e aftësive psikomotorë, njohëse, emocionale, shoqërore dhe morale të personalitetit;
- respektimin e barazisë së shanseve për të gjithë fëmijët, përkundrajt përjashtimit social dhe diskriminimit gjinor, racor, kulturor.

Është me rëndësi të kujtojmë **pse** dhe **kur** dhe **si** nxënë fëmija/parashkollori.

4.1.1 Pse mësojnë fëmijët?

Fëmija lind me dëshirën për të mësuar përmes zbulimit. Interesi dhe kurioziteti e shtojnë fëmijën të zbulojë gjëra dhe të fitojë përvojat e para për mjedisin përreth. Fëmijët nxiten nëpërmjet informacioneve, lodrave, detyrave dhe punëve të vogla me qëllim që të shuajnë kuriozitetin dhe të mësojnë duke vepruar praktikisht.

4.1.2 Kur mësojnë fëmijët?

Përvojat dhe mjediset e fëmijërisë ndikojnë te dëshira dhe te zhvillimi i aftësive të fëmijëve për të nxënë. Fëmijët përfitojnë nga veprimtaritë dhe përvojat nëse kanë një fëmijëri të shëndetëshme në kuptimin e gjerë të fjalës. Një atmosferë e ngrohtë, e gëzueshme, në një hapësirë fizike relativisht të përshtatëshme është e rëndësishme për zhvillimin dhe të nxënë të fëmijëve. Në jetën e përditshme dhe në mjediset ku ndodhet, fëmijët do të gjejnë gjëra që tërheqin interesin e tyre për të nxënë. Fëmijët nuk mësojnë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë.

4.1.3 Si mësojnë fëmijët?

Ka mënyra të ndryshme si mësojnë fëmijët:

- **Nëpërmjet të bërit dhe të provuarit në praktikë.** Një fëmijë mëson më shumë duke bërë diçka sesa duke i treguar se si bëhen gjërat.
- **Nëpërmjet zbulimit dhe eksplorimit.** Duke parë, prekur dhe ndërvepruar me mjedisin përreth, fëmija zbulon si funksionojnë gjërat, si sillen, çfarë ndodh me gjërat që e rrethojnë, duke zbuluar edhe marrëdhëniet shkak-pasojë.
- **Nëpërmjet pyetjeve dhe bisedave të ndryshme.** Kurioziteti dhe dëshira për të ditur për botën që e rrethon e drejton fëmijën të bëjë shumë pyetje, të dëgjojë dhe të zhvillojë të folurin.
- **Nëpërmjet imitimit dhe lojës me role.** Gjatë imitimit të veprimeve dhe sjelljes së të rriturve fëmijët fillojnë të luajnë si të tillë dhe gradualisht të kuptojnë marrëdhëniet me njëri-tjetrin.

4.2 Metodat pedagogjike në parashkollor

Metodat pedagogjike që përdoren në arsimin parashkollor janë:

- Metoda e bazuar në lojë
- Metoda e përqendruar te fëmija
- Metoda e bazuar te integrimi tematik
- Metoda e bazuar në projekte
- Metoda multikulturore

4.2.1 Metoda e bazuar në lojë

Loja është jetësore për zhvillimin e shëndetit dhe të nxënit të fëmijëve. Loja prek të gjitha aspektet e jetës dhe ndihmon në zhvillimin emocional, njohës, fizik dhe social të fëmijëve.

Gjatë lojës, fëmijët eksplorojnë mjedisin rreth tyre, mësojnë duke punuar dhe krijojnë lidhje me të. Ata mund t'i shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre nëpërmjet lojës më lehtë sesa t'i shprehin me fjalë. Nëpërmjet lojës fëmijët mund të jenë dikush, në çdo vend dhe në çdo kohë. Është loja që u mëson fëmijëve të ndërtojnë një kala, të sillen si në një familje të vërtetë, të imitojnë veprime dhe të kuptojnë se ç'është e mira dhe e keqja, çfarë duhet të bëjnë në jetë dhe çfarë jo.

Loja është mënyra më natyrale në të cilën fëmija nxë. Pjesa më e madhe e lojërave që luajnë fëmijët e moshës parashkollore janë simbolike. Fëmijët *bëjnë gjoja sikur, janë dikush me një veprim ose objekt duke nënkuptuar një veprim ose një objekt tjetër.*

Vlerat e lojës në zhvillimin dhe të nxënin e fëmijës janë:

- **Loja zhvillon aftësi të rëndësishme mendore.** Loja ndihmon fëmijët të përqendrohen, të arsyetojnë dhe të organizojnë të menduarin e tyre. Duke bërë kështu që ata të mësojnë të zgjidhin problemet. Kërkimet për rritjen dhe zhvillimin e trurit mbështesin nevojën për lojera aktive dhe simuluese për të gjithë fëmijët. Loja i jep mundësi fëmijëve të shprehin mendimet dhe idetë. Ajo jep mundësi për të organizuar, planifikuar, zgjidhur probleme, arsyetuar, për të gjetur zgjidhje, për të përdorur aftësi, për të krijuar dhe eksploruar. Sipas Piazhësë (1952) loja i lejon fëmijët të ndërtojnë njohuritë nëpërmjet asimilimit, sigurimit të informacionit, nëpërmjet eksperiencave, si dhe nëpërmjet akomodimit ose modifikimit të një këndvështrimi ekzistues. Loja ndihmon fëmijën të formulojë ide dhe t'i testojë ato. Zhvillimet më të mëdha të aftësive të fëmijëve ndodhin gjatë lojës
- **Loja zhvillon aftësi të rëndësishme sociale.** Fëmijët mësojnë të japin dhe të marrin, të mbajnë radhë, të ndajnë dhe të bashkëpunojnë. Gjatë lojërave sociale ata zbulojnë personalitetin e tyre, fuqitë dhe imitimet. Piaget besonte se fëmijët

janë natyralisht të motivuar dhe të interesuar të ndërveprojnë me fëmijët e tjerë dhe kjo bën që ata të jenë më pak egocentrik dhe më të vëmendshëm ndaj të tjerëve. Loja individuale është e vlefshme, por në fëmijërinë e hershme loja do të thotë bashkëveprim me të tjerët. Në lojë fëmijët mësojnë të jenë lidera, por dhe ndjekës. Ata provojnë role të ndryshme dhe mendojnë për mundësi të reja. Mësojnë të japin e të marrin, të vendosin veten në pozicionin e dikujt tjetër, të ndiejnë ndjenjat e të tjerëve, të dëgjojnë këndvështrimet e të tjerëve, të ndajnë, menaxhojnë zhgënjimin, luajnë me rregulla dhe të zgjidhin ndryshimet. Loja e inkurajon fëmijën të jetë një shok dhe kontribues, të bashkëpunojë dhe tregojë tolerancë në situata të caktuara.

- **Loja nxit zhvillimin pozitiv emocional.** Loja i ndihmon fëmijët të zhvillojnë një imazh të mirë për veten. Ajo u jep mundësinë të shprehin emocionet e brendshme. Loja duhet të jetë një eksperiencë e bukur, e cila ndihmon për të çliruar tensionin dhe të parandalojë mërzinë. Fëmijët e përdorin lojën për të ndryshuar sjelljen jo të mirë, problemet dhe gjithashtu për të larguar stresin, vuajtjet, frikat, ankthet dhe inatin. Loja i ndihmon fëmijët të përkthejnë ndjenjat, mendimet, fantazitë, tendencat në veprime në mënyrë që ta kenë në kontroll botën dhe ndjenjat e tyre. Liria për të eksperimentuar me materialet, ndjenjat, fjalët dhe idetë i jep shtysë zhvillimit të kreativitetit.
- **Loja nxit zhvillimin motorik fizik.** Zhvillimi motorik i fëmijës varet nga përvojat e lojës. Nëse fëmijëve nuk do t'u jepen mundësi të mjaftueshme, atëherë ata nuk do të jenë të aftë sa bashkëmoshatarët që kanë përvoja të tilla. Kur luajnë, fëmijët mësojnë të përdorin muskujt. Ata mund të hidhen, të kërcëjnë, të lëkunden, të presin, të copëtojnë, të rrokullisen, të thurrin dhe të vrapojnë sipas mënyrës së tyre; mund të marrin pjesë në sporte dhe gara të ndryshme.
- **Loja ndihmon në zhvillimin e të folurit në komunikimin me të tjerët.** Nëpërmjet lojës, fëmija mëson të shprehë idetë e veta dhe të komunikojë me të tjerët. Shumë studiues mendojnë që aftësitë e komunikimit zhvillohen nëpërmjet lojës në çift. Loja zgjeron fjalorin dhe rrit zhvillimin gjuhësor duke dhënë mundësi për të përdorur fjalë të reja, për të biseduar me shokët, për të kuptuar

gjuhën e tjetrit dhe këndvështrimin që paraqet. Loja sintetizon eksperiencat e mëparshme dhe mendimet duke lejuar fëmijët t'i bashkojnë ato.

- **Loja i ndihmon fëmijët të eksplorojnë.** Fëmijët mësojnë të eksplorojnë dhe të zbulojnë gjëra të reja. Në vitet e para, fëmijët mësojnë nëpërmjet shqisave, duke prekur, shijuar, parë, ndierë, nuhatur dhe dëgjuar. Kur rriten, fëmijët mësojnë duke i analizuar dhe duke parë të gjitha komponentet përbërës.

4.2.2 Metoda e përqendruar te fëmija

Kjo metodë i referohet një kurrikule që vendos një theks të veçantë tek interesat e fëmijëve dhe është krijuar nga autorë të njohur që kanë një eksperiencë të gjerë në zhvillimin e fëmijërisë së hershme si për shembull, Piazhe, Djui dhe Vigotski. Ndjekësit e rreptë të kësaj metode pretendojnë se një kurrikulë e shkruar mund të jetë shumë e strukturuar dhe mund të mos i përgjigjet shumë interesave të fëmijëve të cilat ndryshojnë me kohën. Ndërsa ndjekësit më të moderuar sugjerojnë se një plan i shkruar është i nevojshëm por mësuesit duhet ta krijojnë atë nisur nga interesat e fëmijëve. Për më tepër, planet mund dhe duhet të ndahen për të lejuar përbushjen e nevojave të fëmijëve. Gjithashtu ata që ndjekin këtë metodë praktikojnë dhe organizojnë kohë të caktuar për të reflektuar mbi sjelljen e fëmijëve dhe mbi punën e tyre. Duke qënë se kjo metodë i lejon mësuesit të planifikojnë bazuar në nevojat e fëmijëve programi që mësuesit hartojnë do të jetë i individualizuar.

Kjo metodë mbështetet në zhvillimin e fëmijës në katër fushat kryesore: në fushën e zhvillimit social-emocional, në fushën e zhvillimit fizik, në fushën e zhvillimit gjuhësor dhe në fushën e zhvillimit njohës.

Njihen 12 parime kryesore (Brede Kamp & Copple, (1996), mbi të cilat është ndërtuar metoda e përqendruar te fëmija:

- Të gjitha fushat e zhvillimit (fizike, sociale, gjuhësore dhe njohëse) lidhen ngushtë dhe ndikojnë te njëra-tjetra;
- Zhvillimi i fëmijës është relativisht një proces i organizuar, gjatë të cilit fitohen aftësi të reja mbështetur në përvojat e mëparshme;

- Zhvillimi ndodh në nivele të ndryshme tek fëmijë të ndryshëm dhe varion individualisht për secilën fushë zhvillimi;
- Përvojat e mëparshme mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në zhvillimin e mëvonshëm të fëmijës;
- Zhvillimi është i parashikueshëm dhe vazhdon me rritjen e kompleksitetit;
- Zhvillimi ndikohet nga konteksti social dhe kulturor;
- Fëmija/ët nxënë në mënyrë aktive duke ndërtuar hap pas hapi njohuritë për botën që i rrethon;
- Trashëgimia dhe mjedisi ku rritet një fëmijë përshpejton ose ngadalëson zhvillimin e tij;
- Loja është e rëndësishme për zhvillimin e shëndetshëm social, emocional, fizik, gjuhësor dhe njohës të fëmijës;
- Fëmija merr një zhvillim më të mirë kur u jepet mundësia për të zbatuar aftësi të reja, përtej atyre që kanë;
- Fëmija ka stile të ndryshme të nxëni dhe mënyra të veçanta se si e prezanton atë që di.
- Fëmija që ndihet i sigurtë, i qetë dhe i vlerësuar zhvillohet në nivel më të lartë.

4.2.3 Metoda e bazuar te integrimi tematik

Një kurrikul me një metodë të integruar mund të përkufizohet në mënyra të ndryshme nga autorë të ndryshëm bazuar mbi vëzhgimet e bëra mbi mësuesit/et që e praktikojnë atë. Për shembull Beane në 1997, pohon se kjo qasje bazohet në pyetjet që fëmijët bëjnë dhe në këtë mënyrë gjenerohet kurrikula. Eriksoni e përkufizon metodën e integruar si një shumëllojshmëri disiplinash të cilat ndjanë të njëjtin fokus konceptual. Edhe pse ekspertë të ndryshëm japin përkufizime të ndryshme mbi këtë lloj qasje të gjithë bien dakort se një program i integruar fillon me një temë të unifikuar, e cila mund të jetë një pyetje, një emer vendi ose objekti një aktivitet ose një event i rëndësishëm, një problem ose çështje, një projekt etj, ku si edukatori/ja dhe fëmija janë të dy të interesuar. Është

për t'u theksuar se kjo qasje është e fokusuar tek fëmija që do të thotë se thekson rëndësinë për t'u fokusuar tek interesat, kultura, nevojat dhe stilet e të nxënit të fëmijës.

Sipas Drake në 1998 bota kërkon përdorimin e aftësive dhe kompetencave të integruara dhe jo të atyre të izoluara dhe thekson që edukimi duhet të aftësojë fëmijët në zgjidhjen e problemave dhe të aplikojë keto mekanizma duke iu përshtatur konteksteve të ndryshme. Kjo metodë i lehtëson dhe aftëson fëmijët të prezantojnë botën në mënyrë sa më të saktë. Përmbajtja me të cilën prezantohen fëmijët mund të jetë sipas fushës së studimit siç edhe ndodh në shkollën fillore. Me përdorimin e kësaj metode, fëmijët kanë një kohë të arsyeshme për të studiuar matematikën, gjuhën, shkencat dhe studimet sociale.

Kurrikula e integruar synon përzgjedhjen e temave të cilat integrojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë nga të gjitha fushat e të nxënit. Të mësuarit e integruar e bëjnë kurrikulën më të përshatshme, duke qenë se lejon një studim të thellë të një teme të zgjedhur. Mësuesi zgjedh temën e përshtatshme që lidhet me nevojat dhe interesin e fëmijëve.

4.2.4 Metoda e bazuar në projekte

Kjo metodë ka një histori të gjatë në fushë dhe është propozuar për herë të parë nga Djui. Metoda e projektit thekson faktin se përmbajtja e kurrikulës duhet të negociohet mes mësuesit dhe fëmijëve. Mësuesit veprojnë sipas një linje të caktuar. Së bashku me fëmijët e ndërtojnë kurrikulën bazuar në përvojat e mëparshme të fëmijëve dhe nevojat për të ardhmen. Metoda e projektit bazohet tek të menduarit dhe të nxënit të qëllimshëm dhe siç e quan Djui “një akt i kompletuar i të menduarit që vjen si nevojë për të zgjidhur problem”.

Aktualisht kjo metodë gëzon shumë popullaritet. Fëmijët mund të bëjnë një investigim në thellësi të një teme nga bota e vërtetë. Kjo metodë përqendrohet në gjetjen e përgjigjeve për pyetjet që ngrihen nga fëmijët, nga mësuesi ose nga të dy. Mund të përdoret nga i gjithë grupi i fëmijëve, por më shpesh përdoren nga një nën-grup i një klase i cili ka interes për temën. Kjo qasje pedagojike angazhon mendjet e fëmijëve në përmbajtje dhe proces (Helm & Katz, 2010) si dhe promovon të kuptuarin e fëmijëve

dhe proceset e të menduarit. Nga studimet është vënë re se kjo metodë është e kënaqshme si për fëmijët ashtu edhe për mësuesit.

Fëmijët dhe mësuesit angazhohen në grumbullimin e informacioneve të reja për temën, zhvillojnë shëtitje në terren, vëzhgojnë, bisedojnë me njerëz të ndryshëm për të marrë informacionin e nevojshëm.

4.2.5 Metoda multikulturore

Zhvillimi i konceptit të gjithëpërfshirjes kërkon integrimin e metodave multikulturore në kurrikul. Ajo bazohet në respektimin dhe kuptimin e përbashkët të kulturave të të tjerëve në mënyrë që ata të bashkëjetojnë duke respektuar njëri-tjetrin. Edukimi i fëmijës fillon në familje dhe detyra e institucionit arsimor është të ndërtojë mbi përvojat që kanë fëmijët. Kur hyjnë në kopsht, gjëja më e rëndësishme për fëmijët është që të ndihen të sigurt dhe të përshtatur në grup. Në aktivitete të ndryshme fëmijët imitojnë të rriturit, flasin për atë që shohin në televizor dhe për veprimtari të tjera që zhvillojnë me të rriturit.

4.3 Gjithëpërfshirja në kurrikulën e arsimit parashkollor – si parim, metodë dhe detyrim ligjor

Gjithëpërfshirja merr parasysh ndryshimet sociale, kulturore dhe gjuhësore ndërmjet fëmijëve (duke përfshirë stilet e të nxëniet, aftësitë, aftësinë e kufizuar, gjininë, rrethanat familjare dhe vendndodhjen gjeografike). Në procesin e gjatë dhe të vështirë të gjithëpërfshirjes synohet që **të gjithë** fëmijët të përfshihen në institucionet parashkollore e të përfitojnë nga veprimtaria mësimore-edukative.

Në këtë kuadër, kurrikula duhet të njohë, të pranojë, të respektojë dhe t'u përgjigjet nevojave, përvojave, interesave arsimore dhe vlerave të të gjithë fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç, pavarësisht nga prejardhja, gjinia dhe aftësia e tyre. Ky parim synon të ndërtojë një kurrikul që krijon mundësi të barabarta për sukses të çdo fëmije 3-6 vjeç. E udhëhequr nga ky parim, kurrikula duhet të ofrojë zgjidhje që mbajnë parasysh nevojat vetjake dhe stilet e të nxëniet, si dhe përvojat mësimore paraprake të fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç, si kusht për përmirësimin e nivelit të arritjeve të tyre.

Konventa për të drejtat e fëmijëve, Konventa për personat me Aftësi të Kufizuar dhe Ligji i Arsimit Parauniversitar 69/2012, kanë në fokus arsimin gjithëpërfshirës që është qasja për të siguruar që çdo fëmijë do të marrë edukim cilësor. Edukimi cilësor, ashtu siç përcaktohet në Deklaratën Salamankës, promovon “njohjen e nevojës për të punuar dhe ecur drejt “institucionit arsimor për të gjithë” – ku institucionet vlerësojnë ndryshimet, mbështesin të mësuarit dhe i përgjigjen nevojave individuale”.

Realizimi i arsimit gjithëpërfshirës kërkon veprimtari të mirëkoordinuara nga shumë njerëz dhe është një proces që merr kohë. Institucionet arsimore gjithëpërfshirëse dhe sistemet arsimore gjithëpërfshirëse nuk krijohen njëherë e përgjithmonë; ato duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen si një proces në vazhdimësi.

4.4 Partneriteti me prindërit dhe komunitetin si parim edukimi, detyrim ligjor dhe metodat për përfshirjen e tyre

Prindërit janë mësuesit e parë të fëmijëve, ata kanë qëllime, përcjellin ideale, vlera dhe kanë dëshira për fëmijët e tyre. Prindërit janë të parët që njohin më mirë se çfarë njih më mirë fëmija e tyre, çfarë i intereson dhe për çfarë është i zoti të bëjë. Prindërit ose personat e kujdesit për fëmijën gjithashtu njohin më mirë se të gjithë personalitetin dhe temperamentin e fëmijës.

Shumë studime konfirmojnë se përfshirja e prindërve në procesin e të nxënit dhe aktivitetet jashtë shtëpisë kontribuon pozitivisht në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës. Këta fëmijë kanë treguar se njohin dhe përdorin një fjalor më të gjerë dhe shfaqin nivel më të lartë vetëbesimi. Autorë të shumtë përshkruajnë si përfiton gjithkush në komunitetin e institucionit arsimor kur mësuesit dhe prindërit bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

Disa nga parimet kryesore të bashkëpunimit me prindërit ose me figurat e kujdesit për fëmijën janë:

- **Parimi 1: Njohja dhe respekti.** Mësuesi duhet të njihet me familjen dhe të respektojë njohurinë dhe ekspertizën e saj, gjithashtu fëmijët vijnë të pasuruar me një gamë të gjerë dijes të cilat i kanë formuar në familjet e tyre. Familjet kanë

rituale dhe tradita që i japin formë mënyrës se si fëmijët e perceptojnë dhe marrin pjesë në botë. Familja njih dhe respekton dijet dhe ekspertizën e mësuesit.

- **Parimi 2: Komunikimi i dyanshëm.** Komunikimi i dyanshëm ndërton partneritet ndërmjet familjeve dhe mësuesve dhe mund të marrë forma të ndryshme. Mësuesit mund të organizojnë takime me prindërit për të zhvilluar biseda për ecurinë e fëmijës, mund të komunikojnë duke shkëmbyer letra me prindërit, mund t’u dërgojnë foto të fëmijës për t’i treguar më shumë rreth një aktiviteti ku fëmija ka marrë pjesë etj. Duhet patur parasysh që të gjitha gjërat e sipërpërmendura kërkojnë kohë dhe është detyra e mësuesve ta menaxhojnë mirë kohën në mënyrë që të mund të zhvillojnë të gjithë aktivitetet e planifikuara.
- **Parimi 3: Vendimmarrja e përbashkët.** Kur bëhet fjalë për marrjen e vendimeve që lidhen me fëmijët është thelbësore që mësuesit t’i përfshijnë prindrit. Është shumë e rëndësishme që prindërit të marrin pjesë në vendimmarrje kur bëhet fjalë për zhvillimin e qëllimeve mësimore, zhvillimin e strategjive si dhe për të trajtuar sjelljet sfiduese. Ata duhet të kontribuojnë në hartimin e politikave të programit, të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat e prindërve ose grupe këshillimore si dhe të marrin pjesë në diskutime me mësues për të diskutuar se si politika të caktuara ndikojnë te fëmija i tyre.
- **Parimi 4: Njohja dhe pranimi i diversitetit.** Diversiteti kulturor i fëmijëve të cilët ndjekin programet e parashkollorit është një dukuri e pranishme në shoqërinë tonë dhe që vazhdon të rritet, kjo për shkak të lëvizjeve të shumta demografike. Fëmijët me *background* të ndryshëm kulturor, etnik, gjuhësor etj., sjellin dinamicitet dhe kompleksitet në komunitetet ku jetojnë. Drejtuesit e kopshteve janë të parët që duhet të sigurojnë që pavarësisht këtij diversiteti të mos zhvillohen paragjykime tek fëmijët, si dhe me anë të veprimtarive të ndryshme të zbusin paragjykimet që prindërit e fëmijëve mund të kenë.
- **Parimi 5: Krijimi i rrjeteve mbështetëse.** Rrjetet dhe marrëdhëniet ndërmjet mësuesive dhe familjeve mund të shërbejnë si një sistem i rëndësishëm mbështetës për familjet me fëmijë të vegjël. Këto rrjete mund të jenë formale ose jo

formale. Rrjetet e formuara mund të jenë mikse mësues-prindër ose mund të jenë rrjete të formuara vetëm për prindrit. Shpesh herë mësuesit/et mund të jenë koordinatorë të cilët lehtësojnë marrdhëniet ndërmjet anëtarëve të rrjetit.

Parimet e mësipërme mund të shërbejnë si një kornizë për të drejtuar të menduarin e mësueseve për përfshirjen më të mirë të familjeve në jetën dhe veprimtarinë e kopshtit.

KAPITULLI V

KURRIKULA REFERUAR STANDARDEVE TË ZHVILLIMIT DHE TË NXËNIT DHE KORRELACIONI MIDIS TYRE

KURRIKULA REFERUAR STANDARTEVE TË ZHVILLIMIT DHE TË NXËNIT DHE KORRELACIONI MIDIS TYRE

5.1 Kurrikula si konfirmim i Standardit dhe i Kompetencave

Kompetencat e përcaktuara në Kornizën Kurrikulare rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parashkollor dhe përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënit, të cilat duhet t'i arrijnë fëmijët në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parashkollor, në përputhje me Standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç.

Standardet përshkruajnë sjelljet, aftësitë dhe njohuritë që duhet të kenë ose të jenë të aftë t'i tregojnë fëmijët e kësaj grupmoshe. Standardet përcaktojnë çfarë mund dhe janë në gjendje të bëjnë, të thonë dhe të demonstrojnë fëmijët gjatë rritjes, zhvillimit dhe kalimit nga njëra grupmoshë në tjetrën. Përcaktimi i standardeve, i treguesve dhe i strategjive për përmbushjen e tyre ka për qëllim edukimin dhe transmetimin e vlerave njerëzore dhe të cilësive më të mira të popullit shqiptar, si: krenaria kombëtare, bashkëpunimi, ndihma, respektimi i të tjerëve, empatia, ndershmëria, dashuria, vullneti, këmbëngulja, menaxhimi i emocioneve, toleranca, mirëkuptimi, diversiteti etj. Standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç janë hartuar duke patur parasysh qasjen e re të bazuar në kompetenca. Duke pasur në qendër fëmijët dhe duke u hartuar për ta, ky dokument paraqet mundësitë dhe arritjet e fëmijëve në periudha të caktuara moshore në çdo fushë zhvillimi. Qëllimi kryesor i standardeve është mbështetja e zhvillimit më të mirë të fëmijëve të moshës parashkollore.

5.2 Standardet në arsimin parashkollor

Të gjitha fushat e zhvillimit dhe të të nxënit janë të rëndësishme. Proceset e zhvillimit dhe të të nxënit ndjekin njëra-tjetrën dhe ndikohen nga faktorë të ndryshëm ekonomikë, socialë e kulturorë. Zhvillimi dhe të nxënët vijnë si rezultat i arritjes së pjekurisë së fëmijës në një moshë të caktuar me përvojën e fituar gjatë rritjes. Fëmijët mësojnë në

mënyra të ndryshme, por loja dhe eksplorimi mbeten veprimtaritë kryesore prej të cilave mësojnë fëmijët e kësaj grupmoshe.

Hartimi i dokumentit të standardeve është bazuar në parimet e mëposhtme të cilat përcjellin besimin e ekspertëve se:

- **Besimi 1. Të nxënit dhe zhvillimi i fëmijës është shumëdimensional.** Fushat e zhvillimit janë të ndërlidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën. Kjo nënkupton që zhvillimi i fëmijës në një fushë ndikon zhvillimin e tij/e saj edhe në fushat të tjera. Prandaj, fushat e zhvillimit nuk mund të konsiderohen të izoluara nga njëra-tjetra, ato pikëpëriten dhe aty ku ndodh pikëprerja ndodh dhe zhvillimi. Ndërveprimi dinamik i tyre duhet të merret parasysh nga i rrituri, në mënyrë që fëmijës t'i jepet mundësi që të zhvillojë potencialin e vet.
- **Besimi 2. Fëmija është potencialisht i pajisur me aftësi të veçanta.** Të gjithë fëmijët janë potencialisht të aftë për të arritur rezultate pozitive në zhvillimin e tyre. Pavarësisht nga prejardhja dhe përvojat që kanë, mësuesit/et e arsimit parashkollor punojnë në përputhje me mundësitë e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve, por edhe duke u ofruar përvoja sfiduese, nëpërmjet të cilave nxitet progresi zhvillimor dhe interesi i çdo fëmije për të mësuar dhe përvetësuar njohuri dhe aftësi të reja. Është e rëndësishme të kuptohet nga i rrituri që për të gjithë fëmijët e vegjël duhet të ketë pritshmëri të mëdha, në mënyrë që ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Nëse të rriturit i kanë pritshmëritë të pakta për fëmijët, edhe rezultatet do të jenë më të vogla, duke rrezikuar frenimin e zhvillimit të tyre potencial.
- **Besimi 3. Fëmijët janë individë që zhvillohen me ritme të ndryshme.** Çdo fëmijë është unik dhe rritet e zhvillon aftësitë dhe kompetencat e veta në bazë të ritmit individual. Mësuesit/et e arsimit parashkollor duhet të njohin mirë karakteristikat unike zhvillimore të moshës parashkollore dhe ta përthyejnë¹¹ kurrikulën në përputhje me përmbushjen e nevojave të çdo fëmije. Disa fëmijë mund të kenë vonesa të identifikuar në një fushë të caktuar zhvillimi, vështirësi

¹¹ Plani edukativ individual (PEI)

në të nxënë ose aftësi të kufizuar. Mësuesit/et e arsimit parashkollor i përshtasin pritshmëritë e përcaktuara në standardet e parashkollorit në përputhje me zhvillimin e këtyre fëmijëve. Kjo nuk do të thotë që për këta fëmijë duhen hartuar standarde të tjera. Standardet e zhvillimit dhe të të nxënësve janë të njëjta për të gjithë fëmijët, por rruga, mënyra dhe koha që duhet në dizpozicion për t'i përmbushur ato ndryshon nga njëri fëmijë te tjetri.

- **Besimi 4. Fëmijët demonstrojnë njohuritë, aftësitë kompetencat në çdo fushë zhvillimi.** Nuk duhet të pritët që të gjithë fëmijët e një grupmoshe të arrijnë t'i përmbushin standardet në të njëjtën kohë apo t'i tregojnë aftësitë dhe kompetencat që zotërojnë në të njëjtën shkallë zhvillimi. Fëmijët mund të tregojnë se janë më të prirur dhe më të zhvilluar në disa fusha zhvillimi ndërkohë që mund të tregojnë që kanë vështirësi apo kanë një zhvillim më të ngadaltë në të tjera fusha zhvillimi. Parë në këtë këndvështrim, mësuesit/et e arsimit parashkollor duhet të njohin individualitetin e çdo fëmije, të planifikojnë dhe të zhvillojnë veprimtari duke iu referuar pikave të forta dhe ta ndihmojnë të ecë e të përparojë në fushat më sfiduese (në ato që kanë më shumë vështirësi). Nëpërmjet kësaj strategjie, fëmijët do të bëjnë hapa të vegjël progresi drejt përmbushjes së standardeve të edukimit parashkollor në secilën fushë, përfshirë këtu edhe ato fusha në të cilat paraqesin vështirësi.
- **Besimi 5. Fëmijët nxënë nëpërmjet ndërveprimit.** Fëmijët zhvillohen dhe mësojnë më së miri duke u ballafaquar. Në këtë ballafaqim i rrituri është vetëm orientues, nuk pengon nismat dhe kreativitetin/krijimtarinë e fëmijëve, përkundrazi i nxit ata vazhdimisht në këtë drejtim duke krijuar një mjedis sa më motivues. Sugjerohet që sfidat të jenë spontane dhe sa më të natyrshme pasi të mësuarit buron nga përvoja jetësore e vetë fëmijës.
- **Besimi 6. Prindërit janë mësuesit e parë të fëmijës.** Prindërit janë mësuesit e parë dhe kryesorë të fëmijës dhe si të tillë ata kanë mundësinë dhe pushtetin që të ndihmojnë fëmijët e tyre të rriten, të edukohen dhe të zhvillohen në mënyrë të shëndetshme. Prandaj përfshirja e tyre në të gjitha aspektet e jetës së fëmijës përfshirë këtu edhe në arsimin parashkollor është shumë e rëndësishme. Vetëm

në këtë mënyrë fëmijët kanë mundësi të shfaqin plotësisht potencialin e tyre në jetë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre gjuhësore, sociale, fizike, mendore, krijuese dhe intelektuale.

- **Besimi 7. Fëmijët mësojnë më mirë kur ndihen të sigurtë.** Kur marrëdhëniet që ndërtojnë fëmijët janë të sigurtat e të qëndrueshme, kur ndërveprimi kopësht familje është pozitiv, atëherë fëmijët rriten të shëndetshëm në të gjitha aspektet. Fëmijëria e hershme është një periudhë e rëndësishme në jetën e çdo fëmije. Studimet kanë treguar që përgatitja e fëmijëve për në shkollë fillon shumë më herët sesa kur ata janë pesëvjeçarë. Stimulimet dhe ndërhyrjet e hershme janë shumë të rëndësishme dhe të pazëvendësueshme tek fëmijët dhe efekti i tyre reflektohet fuqishëm në periudhat e mëvonshme të zhvillimit. Nga ana tjetër, të gjithë fëmijët kanë potencial të arrijnë pjesën më të madhe të standardeve për një moshë të caktuar, sigurisht me stimulim, nxitje, mbështetje dhe udhëzime përkatëse. E thënë ndryshe, që një fëmijë të rritet dhe të zhvillohet ka nevojë jo vetëm për mbrojtje, ushqim dhe kujdes shëndetësor, por edhe për ndërveprim, nxitje, siguri, dashuri dhe proces të mësuarit nëpërmjet eksplorimit të mjedisit në të cilin ai rritet.

5.2.1 Organizimi dhe struktura e standardeve.

Fëmija zhvillohet në tërësi, ndaj mbivlerësimi apo nënvlerësimi i cilësdo fushe zhvillimore është i gabuar, sepse fëmija nuk zhvillohet në mënyrë të fragmentuar. Prandaj edhe ndarja në mes fushave në këtë dokument është kryesisht formale.

Standardet e zhvillimit dhe të të nxënies të fëmijëve 3-6 vjeç trajtojnë këto fusha zhvillimi:

- **Shëndeti, mirëqenia fizike dhe zhvillimi motorik.** Standardet e kësaj fushe kanë lidhje me treguesit e zhvillimit fizik të fëmijëve 3-6 vjeç. Vetë këta tregues kanë lidhje me aftësitë e fëmijëve për të përdorur muskujt e duarve, koordinimin sy-dorë, muskujt e mëdhenj, nëpërmjet të cilës fëmijët realizojnë prekjen dhe manipulimet me objekte të ndryshme, kryejnë ecje, lëvizje dhe veprimtari të tjera fizike. Gjithashtu, standardet e kësaj fushe lidhen edhe me praktika të

shëndetshme të higjienës, të cilat trajtohen si procedura rutinë në regjimin ditor të fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, siç janë të ushqyerit, kujdesi për veten etj.




- **Zhvillimi social dhe emocional.** Standardet për këtë fushë përfshijnë sjellje dhe veprime që reflektojnë rritjen dhe zhvillimin emocional të fëmijëve, aftësitë e tyre për të hyrë në komunikim dhe për të krijuar marrëdhënie me bashkëmoshatarët, me mësuesit dhe të rritur të tjerë.




- **Zhvillimi njohës dhe njohuri të përgjithshme.** Standardet e kësaj fushe janë të lidhura me proceset njohëse të cilat mundësojnë të nxënë të çdo fëmije dhe fitimin e njohurive për botën që e rrethon. Shprehitë e fëmijëve në aspektin e zhvillimit njohës janë të lidhura me aftësitë e fëmijëve për të mbajtur mend, për të kuptuar e

përdorur gjuhën e simboleve e të shenjave, për të mbledhur dhe përdorur informacionin, Treguesit e standardeve përcaktojnë mënyrën se si fëmija përfshihet në një aktivitet të të nxënit, duke mësuar koncepte, duke formuar ide dhe duke krijuar simbole, përmes veprimtarive të ndërmarra prej vetë atij/asaj.




- **Zhvillimi gjuhësor, leximi dhe shkrimi.** Standardet e kësaj fushe reflektojnë njohuritë dhe shprehjet kryesore që fiton fëmija me rritjen dhe zhvillimin në lidhje me të shprehurit, komunikimin me të tjerët, të lexuarit e të shkruarit. Në fokus të kësaj fushe janë aftësitë që kanë fëmijët për të shprehur veten, idetë dhe mendimet e tyre, fjalori që zotërojnë, njohja e shkronjave, drejtshqiptimi i tingujve, aftësitë për të dalluar gjuhën e folur dhe të shkruar etj.



- **Përfaqja ndaj të nxënit.** Standardet e kësaj fushe përqendrohen në sjelljet, veprimet, parakushtet e domosdoshme dhe qëndrimet bazë që fiton fëmija gjatë rritjes, gjatë fitimit të pëvojave të të nxënit dhe në marrëdhënie me të tjerët. Këto aktivitete të nxitura prej vetë fëmijës, brenda kontekstit social në të cilin ai bën pjesë, bëjnë të mundur që ai të përfshihet natyrshëm në përvoja interesante, të mbajë përgjegjësi, të

zhvillojë aftësitë vëzhguese, kuriozitetin dhe dëshirën për të njohur gjithçka që e rrethon. Gjithashtu, veprimtaritë në të cilat përfshihet fëmija e ndihmojnë të ndërtojë kuptimin për botën që e rrethon, duke qëndruar i përqendruar dhe duke zhvilluar dëshirën për të nxënë, përmes shfaqjes së kureshtjes, ndjenjës së përgjegjësisë, iniciativës për të krijuar, për të marrë vendime dhe përmes këmbënguljes. Nëse aftësi të tilla nxiten në fëmijërinë e hershme, atëherë do të “ prodhojmë” fëmijë të gatshëm për të hyrë në shkollë, e për t’u përballuar me përvojat e reja të të nxënit të ofruar prej saj.



5.3 Të mësuarit dhe zhvillimi në fëmijërinë e hershme

Fushat e të nxënit përbëjnë bazën për organizimin e procesit mësimor-edukativ në institucionet parashkollore. Në arsimin parashkollor punohet me 6 fusha:

1. Fusha "Gjuhët dhe komunikimi"
2. Fusha "Matematika"
3. Fusha "Shkencat e natyrës"
4. Fusha "Shoqëria dhe mjedisi"
5. Fusha "Artet"
6. Fusha "Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti"

Secila nga fushat e të nxënit përbëhet nga një ose disa lëndë, të cilat janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushin treguesit e standardeve për

secilën fushë zhvillimi. Treguesit e standardeve përkojnë me rezultatet e pritshme që duhet të shfaqin fëmijët në përfundim të një grupi parashkollor.

5.3.1 Fusha 1. Gjuha dhe komunikimi.

Gjuha është një pasuri e çmuar njerëzore. Ajo u krijon mundësi njerëzve të zbulojnë veten, të njohin botën rreth tyre, të ndërtojnë marrëdhënie me të tjerët, të shprehin ndjenjat, t'u japin jetë ëndrrave dhe prirjeve e tyre, të pasurojnë botën e tyre emocionale, të zhvillojnë ndjenjën e së bukurës, të zgjidhin probleme, si dhe të prezantojnë njohuritë dhe idetë që kanë për çështje të ndryshme. Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën "Gjuha dhe komunikimi". Dhe është e lidhur me standardet e fushës "Zhvillimi gjuhësor". Kjo fushë u mundëson fëmijëve që të zhvillojnë dhe të përdorin gjuhët si mjete komunikimi në jetën e përditshme, si dhe në veprimtaritë e tyre mësimore e shoqërore, pra të zhvillojnë kompetencat gjuhësore.

Kompetencat gjuhësore ndërtohen dhe zhvillohen gjatë gjithë jetës, por mosha parashkollore është vendimtare për arritjet e fëmijëve. Shpejtësia dhe lehtësia me të cilën fëmijët e vegjël mësojnë të flasin gjuhën, pa qenë të mësuar nga dikush tjetër, është një nga mrekullitë e natyrës. P.sh., nga mosha 3 deri në 5 vjeç fëmijët mësojnë afërsisht 50 fjalë të reja në muaj dhe gjatësia e fjalisë rritet çdo vit. Është detyrë e institucioneve arsimore që të pasurojnë dhe të zhvillojnë te fëmijët njohuritë dhe shkathtësitë gjuhësore, sidomos gjatë viteve të para të jetës. Fëmijëve të vegjël u pëlqen të flasin. Ata i tërheq dhe u pëlqen të dëgjojnë histori të lexuara me zë të lartë në grupe të vogla apo në praninë e të rriturve. Atyre u pëlqen të shkëmbejnë librat e preferuar, "të lexojnë" libra dhe të ritregojnë histori. Në këtë mënyrë, mësimi i gjuhës ndodh brenda një konteksti social dhe kulturor. Mjedisi shoqëror u ofron fëmijëve më shumë sesa vetëm fjalë dhe kuptime. Fëmijët mendojnë dhe veprojnë në mënyra shoqërisht të pranueshme. Fëmijët mësojnë edhe rreth shoqërisë, ndërsa janë duke mësuar gjuhën.

Njohuritë dhe shkathtësitë e gjuhës së folur përbëjnë themelet për zhvillimin e mëtejshëm të shkathtësive të leximit dhe të shkrimit. Një hap i madh e i rëndësishëm në jetën e fëmijës është fillimi i mësimi të shkrimit. Në vitet e para, fëmija ka një shkrim që ngjason me shkarravina në formë rrethore. Më pas, fëmija përpiket t'i kthejë këto

shkarravina në forma më të rregullta dhe të njohë shkronjat. Aktivitetet, në të cilat fëmija ka mundësi të shkruajë në sipërfaqe vertikalisht, i japin mundësi të pozicionojë mirë kyçin e dorës dhe të përdorë mirë muskujt e gishtave në vend të muskujve të krahut. Fëmija duhet të ketë mundësinë të shkruajë në sipërfaqe të ndryshme e me materiale të ndryshme. Fillimisht ata i bëjnë shkronjat shumë të mëdha, por, më pas, ato do të zvogëlohen gradualisht. Shkronjat e para mund të kërkojnë që çdo shkronjë të harxhojë një fletë më vete. Megjithatë aktivitetet e shkrimit nuk duhet të jenë të gjata dhe duhet të jenë të mbushura me mundësi që fëmija të vetëqetësohet. Shkrimi mund t'u duket i frikshëm fëmijëve të kësaj moshe, ndaj dhe aktivitetet duhet të planifikohen me kujdes, në mënyrë që t'i ndihmojnë fëmijët të kenë një qëndrim pozitiv ndaj shkrimit që në hapat e para.

Siç shihet, një arsim parashkollor cilësor është një parakusht i rëndësishëm jo vetëm për suksesin e fëmijëve në shkollë, por edhe në jetë, ndaj është detyrë e mësuesve të këtij cikli të mundësojnë ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave për të nxënit gjatë gjithë jetës.

5.3.2 Fusha 2. Matematika

Fëmijët e vegjël janë kuriozë në mënyrë të natyrshme dhe zhvillojnë idetë matematikore që në fëmijërinë e hershme. Ata duan të kuptojnë mjedisin që i rrethon nëpërmjet vëzhgimeve, ndërveprimeve në shtëpi dhe në komunitet. Të mësuarit e matematikës zhvillohet në aktivitetet e përditshme, duke luajtur, duke treguar, duke prekur apo duke ndihmuar të tjerët. Këto aktivitete ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e numrit dhe kuptimin e hapësirës. Kuriozitetet në lidhje me matematikën nxiten kur fëmijët krahasojnë sasi, kur kërkojnë modele, dallojnë objekte, duke ndërtuar blloqe etj.

Një komponent kyç në zhvillimin e matematikës praktike është lidhja me eksperiencat personale të fëmijës. Mjedisi mësimor i fëmijës duhet të vlerësojë dhe të respektojë diversitetin e përvojave të fëmijëve, në mënyrë që ata të ndihen sa më "rehat" me matematikën dhe të nxiten të bëjnë sa më shumë pyetje duke zhvilluar kërshtërinë e tyre. Matematika është shkenca, gjuha universale e së cilës, ndihmon fëmijën, të kuptojë dhe të veprojë në realitetin që jeton. Kjo e bën atë të japë një kontribut të rëndësishëm

për zhvillimin intelektual të fëmijës dhe për formimin e identitetit të tij. Nëpërmjet matematikës fëmija zhvillon përvoja nga më të thjeshtat te më komplekset dhe nga më konkretet te më abstraktet. Nëpërmjet mësimit të matematikës, fëmija merr njohuri mbi numrat, figurat, hapësirën, masat etj. Fusha e matematikës është e lidhur me standrdet e fushës “Zhvillimi njohës dhe njohuri të përgjithshme”. Treguesit e nënfushës “Zhvillimi matematikor” shërbejnë si rezultate të nxëni për secilën nga grupmoshat 3-4, 4-5 dhe 5-6 vjeç

5.3.3 Fusha 3. Shkencat e natyrës

Shkenca është veprimtari intelektuale dhe praktike që përfshin studimin sistematik të strukturës dhe sjelljes së botës fizike dhe natyrore përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Kompetencat që kjo fushë zhvillon u shërbejnë individëve në aspektin personal, social dhe ekonomik.

Fusha e shkencës në arsimin parauniversitar ndihmon në formimin shkencor të fëmijëve nëpërmjet ndërtimit të njohurive të para shkencore, aftësive dhe qëndrimeve të nevojshme për të hetuar, për të zgjidhur problemet, për të marrë vendimet, për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për të bërë pyetje e kënaqur kureshtjen e tyre. Përvojat e të nxënit në shkencë u krijojnë nxënësve mundësi të shumta për të kuptuar, për të eksploruar, për të analizuar, për të vlerësuar, për të sintetizuar, për të çmuar marrëdhëniet ndërmjet shkencës, teknologjisë, shoqërisë dhe mjedisit, të cilët ushtrojnë ndikime në jetën e përditshme. Nëpërmjet kryerjes së veprimtarive praktike, eksperimenteve, lojërave të ndryshme, fëmijët provojnë kënaqësinë e zbulimit shkencor dhe plotësojnë kuriozitetin për botën që i rrethon. Ata zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik e krijues dhe sfidojnë vetveten për të bërë pyetje dhe për të arritur në përfundime të njohura, por të reja për ta. Fusha “Shkencat e natyrës” është e lidhur me standardet e fushës “Zhvillimi njohës dhe njohuri të përgjithshme”. Treguesit e nënfushës “Zhvillimi shkencor” shërbejnë si rezultate të nxëni për secilën nga tri grupet e arsimit parashkollor.

5.3.4 Fusha 4. Shoqëria dhe Mjedisi

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” i aftëson fëmijët për të qenë qytetarë aktiv, të informuar dhe të përgjegjshëm për veten, grupin dhe shoqërinë. Përmes kësaj fushe fëmijët zhvillojnë kompetencat e nevojshme për të luajtur rolin e tyre si anëtarë të një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike në një bote gjithnjë e më të ndërvarur.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” është e lidhur me standrdet e fushës “Zhvillimi social dhe personal”, treguesit e të cilës shërbejnë si rezultate të nxëni për të tria grupet e parashkollorit.

5.3.5 Fusha 5. Artet

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme në formimin e fëmijëve nga parashkollori dhe më tej, sepse përfshihen dimensione të kulturës muzikore, pamore, lëvizore, shprehëse, intelektuale dhe emocionale, mbi të cilat ndërveprojnë kultura dhe shoqëria. Kjo fushë u jep mundësi fëmijëve për t’u njohur dhe për të zhvilluar njohuritë artistike përmes lojës duke kuptuar si funksionojnë *tingujt, ngjyrat, format, fjalët dhe lëvizjet*. Të gjitha këto mësohen, formohen dhe kultivohen përmes zbulimeve konkrete nga jeta e përditshme, *elementet tingullore dhe ritmike* nga mjedisi, të cilat i provojnë dhe i përjetojnë ato në forma të ndryshme përmes dëgjimit, krijimit, këndimit; *format, ngjyrat* dhe dukuri të tjera pamore; zbatimi i ritmeve të ndryshme përmes kombinimit me lëvizjen; shprehja e emocioneve përmes fjalës etj. Fusha “Artet” është e lidhur me standardet e fushës “Zhvillimi njohës dhe njohuri të përgjithshme”. Treguesit e nënfushës “Zhvillimi artistik” shërbejnë si rezultate të nxëni për secilën grupmoshë.

5.3.6 Fusha 6. Edukimi Fizik, sportet dhe shëndeti

Kjo fushë u jep mundësi fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç të fitojnë kompetenca për ruajtjen e shëndetit të tyre dhe të tjerëve, respektin për vetveten dhe ruajtjen e organizmit nga dëmtimet e mundshme gjatë të ushtruarit me aktivitet fizik e sportiv. Aktiviteti fizik i ndihmon fëmijët të përmirësojnë aftësitë fizike dhe koordinative, personale dhe ndërpersonale, duke u rritur të shëndetshëm. Nëpërmjet ushtrimit me

aktivitet fizik, fëmijëve u krijohet mundësia për të marrë pjesë në një shumëllojshmëri veprimtarish fizike e lojëra në mënyrë individuale ose në grup. Fusha “Edukimi fizik, sporte dhe shëndet” është e lidhur me standardet e fushës “Shëndeti, mirëqënia fizike dhe zhvillimi motorik”. Treguesit për secilin standard shërbejnë si rezultate të nxëni për fëmijët e moshës 3-4, vjeç, 4-5 dhe 5-6 vjeç.

KAPITULLI VI

MJEDISI FIZIK DHE QENDRAT E TË NXËNIT

6.1 Mjedisi fizik - kusht për cilësi, standard dhe kompetencë në intitucionet parashkollore

Kur flasim për mjedis fizik nënkuptojmë mjediset e brendshme dhe të jashtme të kopshtit, mjediset e lojës, këndet e të nxënit, infrastruktura fizike, hapësira, mjediset e tualetit, mjediset ku flenë fëmijë kur ato janë me drekë, mjedise për të ngrënë, mjedise për mbajtjen e veshjeve personale, oborr etj. Mjediset e jashtme krijojnë mundësi për fëmijët të ushtrojnë forcën e muskujve në veprimtaritë dhe lojërat në natyrë, të zhvillojnë një shfaqje dramatike, ku të përfshihen sa më shumë pjesëmarrës. Fëmijëve u duhet siguruar një mjedis stimulues, që nxit procesin e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç. Një mjedis fizik i shëndetshëm u ofron fëmijëve mundësi për të përjetuar përvoja të ndryshme.

Rregullimi i mjedisit dhe i materialeve kanë rëndësi për të nxënin, sepse ndikojnë në:

- Zhvillimin gjuhësor
- Zhvillimin njohës
- Zhvillimin fizik
- Krijimtarinë
- Zhvillimin social dhe emocional

Mjedisi është vendi ku zbatohet dhe zhvillohet në mënyrë krijuese kurrikula, ndaj dhe mënyra sesi ai modelohet mund të ndihmojë ose të pengojë përmbushjen e qëllimeve kurrikulare. Kur ai modelohet në përputhje me qëllimet kurrikulare atëherë mjedisi:

- Nxit te fëmijët ndjenjën e përkatësisë, përkujdesjes brenda dhe ndërmjet fëmijëve;
- Nxit dëshirën te fëmijët për pavarësi;
- Ndihmon fëmijët të jenë të sigurt dhe të shëndetshëm;
- Rrit pjesëmarrjen e familjes në programin parashkollor;
- Lehtëson përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në programit e arsimimit parashkollor.

Për ta modeluar mjedisin në një përputhje me qëllimet kurrikulare, mësuesi duhet të marrë në konsideratë marrëdhënien ndërmjet mjedisit, qëllimeve kurrikulare dhe natyrën e veçantë të çdo fëmije duke përfshirë në veçanti:

- Moshën e fëmijëve;
- Interesat dhe aftësitë individuale të secilit fëmijë;
- Kulturën dhe vlerat e familjes së fëmijës;
- Nevojat e grupit;
- Misionin, vizionin dhe filozofinë arsimore të sistemit parashkollor.

6.2 Hapësirat ku fëmijët mësojnë, zhvillohen dhe ndërveprojnë

Në hapësirat ku fëmijët mësojnë, zhvillohen dhe ndërveprojnë përfshihen jo vetëm hapësirat e brendshme, por edhe hapësirat e jashtme, në oborrin e kopshtit, në natyrë, në këndin e lodrave, në park apo edhe në mjedise të tjera komunitare. Gjithashtu brenda këtij koncepti përfshihet edhe ajo që quhet hapësirë kalimtare, ku fëmijët hyjnë e dalin gjatë zhvillimit të programit ditor në institucionin e arsimit parashkollor. Hapësirat dhe mënyra se si janë rregulluar artikujt, objektet dhe orenditë për të mundësuar procesin e të nxënies si dhe të zhvillimit të tyre. Këtu përfshihen: hapësira personale për fëmijët (rafte, varëse, etj), hapësira për mësim në grup të vogël, për mësim në grup të madh, hapësira për të ngrënë, hapësira për të fjetur, hapësira për aktivitete mësimore në qendra etj.

6.2.1 Godina e Kopshtit

Godinat e kopshteve duhet të jenë mbresëlënëse, të jenë të pastra, të ndriçuara mirë, të ajrosura në mënyrë të përshtatshme dhe të dekoruara. Dhomat e përdorura për kujdesin e fëmijëve duhet të jenë me një temperaturë të përshtatshme për fëmijët 18-26 gradë Celsius. Ndriçimi i studiuar, mund të zbehet gjatë pushimit ose gjatë kohës kur fëmijët dëshirojnë të flenë. Niveli i zhurmave në godinë duhet të jetë i përshtatshëm për fëmijët dhe të rriturit. Në godinë duhet të ketë të paktën një tualet dhe një lavaman për 10 fëmijë. Ato duhet të jenë të ndërtuara në mënyrë të tillë që të lejojë përdorimin e tyre lirisht edhe nga fëmijët me aftësi të kufizuara. Dyert e banjave të fëmijëve nuk duhet të

kenë reze për t'u mbyllur nga brenda. Tualeti duhet të jetë i pajisur me ujë të rrjedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë. Uji i ngrohtë nuk duhet të jetë më shumë se 48 gradë C. Në tualet duhet të ketë gjithashtu edhe sapun për të larë duart, letra për të fshirë duart për çdo fëmijë si dhe letër higjienike. Tualeti dhe lavamani i të rriturve duhet të jenë të veçantë.

6.2.2 Mjedisi i Jashtëm

Mjedisi i jashtëm i institucionit është fizikisht i sigurt dhe nxit lojën dhe të nxënit. Oborri duhet të jetë i pajisur me një sasi të mjaftueshme mjjetesh, që u përshtaten grupmoshave të fëmijëve parashkollorë dhe të përdorën nga të gjithë fëmijët me radhë. Gjatë veprimtarive të zhvilluara në oborrin e institucionit, mesatarisht çdo fëmijë duhet të ketë në dispozicion 5-6 m². Në oborr duhet të ketë një vend të pajisur me mjete për secilën grupmoshë parashkollore. Oborri duhet të jetë i rrethuar me mur rrethues, me kangjella ose me shkurre në një lartësi 2.3 m dhe duhet të sigurohet që në oborr të mos ketë asnjë objekt që mund të rrezikojë jetën e fëmijëve apo bimë helmuese. Të gjitha pajisjet në mjedisin e jashtëm ndërtohen dhe montohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë jetën dhe veprimtarinë e fëmijëve. Në zonën ku montohen rrëshqitësja, lisharësi etj., toka mbulohet me material të butë si rërë apo tapet plastik. Gjatë zhvillimit të veprimtarive në oborr, stafi pedagogjik duhet që t'i mbajë nën vëzhgim të gjithë fëmijët gjatë gjithë kohës.

6.2.3 Mjediset e Brendshme

Hapësira e brendshme ka rëndësi të madhe për shkak se procesi i edukimit të fëmijëve 3-6 vjeç, fillon në këtë hapësirë. Është pikërisht klasa vendi ku zbatohet procesi mësimor/edukativ sipas parimeve didaktike edhe në përputhje me nevojat e arsimit të fëmijëve të kësaj grupmoshe.

Mjedisi i brendshëm i institucionit për të përmbushur qëllimet kurrikulare duhet të jetë i sigurt, i pastër dhe i ndërtuar në përmasa të përshtatshme për fëmijët parashkollorë, ku përfshihen edhe standartet për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Hapësirat e lojës duhet të jenë të mëdha mjaftueshëm që t'i japin fëmijës mundësi dhe

liri lëvizjeje. Ato duhet të jenë të organizuara në mënyrë të tillë që të sigurojnë hapësirë për lloje të ndryshme aktiviteteve. Shtresat e dyshemesë duhet të jenë të dukshme. Gjithashtu ato duhet të kenë një sipërfaqe resistente ndaj rrëshqitjes. Hapësira e brendshme në dispozicion të veprimtarive të fëmijëve duhet të jetë të paktën 2.5 m² për një fëmijë, pa marrë parasysh sipërfaqet e tjera si tualetet, depot, zyrat etj., që përdoren nga të gjithë. Mjetet e zjarrit, prizat, çelësat elektrikë dhe sendet apo objektet e tjera në përdorim të rriturve nuk duhet të jenë të arritshme nga fëmijët.

Në mjedisin e brendshëm të institucionit përcaktohet zona e ngrënies. Mjedisi i ngrënies është i arritshëm për të gjithë fëmijët. Tavolinat dhe karriget, në zonën e ngrënies, vendosen në mënyrë që fëmijët të lëvizin lirisht. Ato janë në gjendje të mirë dhe në përmasa të përshtatshme për fëmijët parashkollore. Nëse tavolinat dhe karriget, që përdoren për të ngrënë, kanë edhe përdorim tjetër, atëherë duhet të sigurohet pastrimi i tyre para dhe pas ngrënies.

6.2.4 Paisjet

Kopshti duhet të ketë pajisje loje të mjaftueshme dhe të përshtatshme me zhvillimin dhe moshën e fëmijëve. Këto pajisje duhet të jenë të arritshme nga fëmijët (në dispozicion të fëmijëve) qoftë për lojrat brenda dhe jashtë qendrës, të cilat sigurojnë aktivitete që nxisin të gjitha fushat e zhvillimit të fëmijëve dhe procesin e të mësuarit të tyre gjatë kohës që ata qëndrojnë nëpër qendra. Mjedisi i brendshëm duhet të jetë i shtruar me tapetë të sigurtë, të cilat duhen vendosur përreth dhe poshtë mjediseve ku luajnë fëmijët. Orenditë ndërtohen duke pasur fëmijët në mendje: karriget, tavolinat, lavamanët dhe tualetet të jenë në përgjigje të përmasave të fëmijëve. Raftet kanë lartësinë e duhur për fëmijët dhe që mundësojnë që fëmijët të kenë mundësi për të marrë materialet e vendosura në to në mënyrë të pavarur.

Pajisjet e lojës në qendër duhet të jenë të përshtatshme me moshën dhe nevojat e zhvillimit të fëmijëve dhe në të njëjtën kohë ato duhet të mbështesin stafin në promovimin e kulturës dhe mundësive të barabarta të fëmijëve. Ato duhet të jenë në gjendje të mirë dhe duhen kontrolluar rregullisht për defekte apo për ndonjë dëmtim të

mundshëm. Pajisjet dhe materialet duhen larë dhe sterilizuar çdo javë. Fëmijët duhen inkurajuar që të respektojnë materialet dhe pajisjet që ata përdorin gjatë zhvillimit të veprimtarive të tyre. Fëmijët duhen mbikqyrur gjatë gjithë kohës që ata i përdorin këto materiale dhe pajisje.

6.3 Qendrat e Veprimtarive

Në realizimin e veprimtarisë mësimore-edukative, një vend të rëndësishëm luajnë qendrat e veprimtarive, ose të ashtuquajtura qendrat e interesave të fëmijëve për të luajtur dhe zhvilluar veprimtari të ndryshme mësimore. Veprimtaritë nëpër qendra mundësojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave mes fëmijëve. Kjo mënyrë pune i ndihmon fëmijët që vazhdimisht të përfitojnë aftësi të reja të komunikimit, duke shmangur situatat konfliktuale të cilat ndodhin si pasojë e mendimeve dhe interesave të ndryshme që kanë fëmijët. Në se cilën qendër duhet të ketë materiale të përshtatshme nëpërmjet të cilave fëmijët mësojnë, luajnë, kërkojnë, zbulojnë, krijojnë, zhvillojnë aftësitë e tyre, zgjidhin probleme, mësojnë të bëjnë zgjedhje, mësojnë të sjellin vendime, të bashkëpunojnë, komunikojnë, bisedojnë me të tjerët, mësojnë të respektojnë njëri-tjetrin dhe rregullat e grupit.

6.3.1 Rëndësia e qendrave

Fëmijët e vegjël mësojnë më mirë duke eksperimentuar me mjedisin e tyre nëpërmjet aktivitete dhe lojërave që luajnë. Përdorimi i qendrave mësimore është e rëndësishme për t'i dhënë fëmijëve përvojat dhe mundësitë për të cilat kanë nevojë.

- **Qendra e blloqeve.** Kjo qendër përbëhet nga pajisje standarde¹². Gjatë kohës që fëmijët ndërtojnë, krijojnë dhe paraqesin përvojat e tyre nëpërmjet lojës me blloqe, ata rriten dhe zhvillohen në të gjitha fushat, sepse ata janë në lëvizje gjithë kohës. Ata stivojnë, ndërtojnë ura, rrethojnë dhe bëjnë struktura të ndërlikuara me blloqet, kubat, shufrat dhe materialet e tjera që ka kjo qendër.

¹² Pajisje standard, në kuptimin që janë projektuar sipas studimeve paraprake për funksionet që do të luajnë në jetën e zhvillimit të fëmijës.

- **Qendra e lojës dramatike.** Nëpërmjet aktrimit, fëmijët identifikohen me modele, role dhe situata unike në mjedisin e tyre. Nëpërmjet dramatizimeve, lojërave në role dhe interpretimeve të ndryshme, fëmijët zhvillojnë ndjenja pozitive për veten dhe aftësitë e tyre interpretuese.

Kur fëmijët përfshihen në lojën dramatike, ata zgjerojnë të kuptuarit e tyre rreth botës dhe zhvillojnë shprehje që u shërbejnë për gjithë jetën. Për këtë arsye, çdo klasë duhet të ketë një qendër të tillë. Pajisjet bazë në një qendër të tillë janë: skena me elementet e saj dhe të gjitha materialet që u duhen fëmijëve për të interpretuar rolet. Sa më krijuese dhe më të ndryshme të jenë skenat, aq më tepër pjesë të dramatizuara do të interpretohen në to. Materialet skenike duhet të jenë të shumta, por jo aq sa “t’u zënë frymën” fëmijëve që punojnë në qendrat e tjera. Suksesi i veprimtarive në këtë qendër varet nga krijimi i kushteve dhe i kërkesave specifike që kërkon ajo.

Për pajisjen e saj me materiale, veshje dhe lodra-kukulla, mësuesja bashkëpunon me prindërit e fëmijëve.

- **Qendra e lodrave dhe e lojërave.** Fëmijët janë të ndryshëm dhe funksionojnë sipas niveleve të ndryshme të aftësive. Për këtë arsye mësuesja siguron materiale të larmishme që t’i tërheqin sa më shumë fëmijët dhe t’u përshtaten interesave që paraqesin. Loja funksionale, konstruktive, dramatike, të bërit “gjoja sikur” dhe lojërat me rregulla u ofrojnë fëmijëve shumë mundësi për të nxënë.

Në këtë qendër, fëmijët mund të luajnë në një veprimtari të qetë, me një shok ose me një të rritur ose në grupe të vogla. Ngritja e kësaj qendre në një vend të posaçëm, pajisja me materiale e lodra të ndryshme dhe organizimi i tyre do të ndikojë te fëmijët për ta shfrytëzuar dhe për t’u kujdesur për lodrat e materialet. Lodrat e materialet duhen vendosur në mënyrë estetike që t’i tërheqin fëmijët për të luajtur dhe për t’u kujdesur për to.

- **Qendra e artit.** Fëmijët zhvillojnë imagjinatën, fantazinë dhe aftësitë krijuese dhe i shprehin nëpërmjet fushave të ndryshme të artit. Fëmijët kanë nevojë çdo ditë për shumë materiale krijuese, për zhvilluar aftësitë artistike, estetike dhe ndjenjën e të bukurës.

Një qendër arti shërben si një burim i madh krijuese për fëmijët, për t'i ndihmuar të shprehin emocionet dhe idetë e tyre. Fëmijët përdorin materiale të ndryshme që ata të krijojnë veprat e tyre të artit. Vendosja e materialeve nxit fëmijët të përfshihen në projektet e arteve. Në një proces krijimi ajo që ka rëndësi më tepër është motivi, përqendrimi tek ajo çfarë fëmija synon të bëjë, sesa cilësia e produktit përfundimtar. Të quash një veprimtari *punë krijuese* nuk do të thotë që ajo të ketë vlera artistike. Aftësitë krijuese të fëmijëve shfaqen në të gjitha qendrat e veprimtarisë, por qendra e artit ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në fitimin ose zhvillimin e aftësive krijuese dhe shprehjen e botës së tyre.

Në këtë qendër, fëmijët vizatojnë, ngjyrosin, thurin, presin, ngjisin, punojnë me plastelinë sipas fantazisë së tyre ose sipas orientimeve që u jepen. Nga vetë natyra e tyre, materialet që përdoren në këtë qendër sigurojnë për fëmijët mundësi të shkëlqyera për të kërkuar, për të bërë *eksperimente*, për të përdorur imagjinatën e tyre dhe për t'u shkarkuar emocionalisht. Veprimtaritë në këtë qendër janë:

- personale dhe origjinale – fëmijët janë të lirë të shprehin botën e tyre nëpërmjet krijimeve artistike;
 - të iniciuara nga fëmijët – fëmijët janë të motivuar instiktivisht;
 - krijuese dhe të larmishme – fëmijët eksplorojnë dhe eksperimentojnë me materiale të ndryshme, janë ata që vendosin çfarë dhe si do të bëjnë;
 - të orientuara drejt veprimit – fëmijët kënaqen më shumë gjatë kohës që punojnë sesa kur arrijnë ta përfundojnë punën;
 - të orientuara drejt suksesit – punët që kryejnë, janë në përshtatje me moshën e fëmijëve edhe pse ndonjëherë materialet i sfidojnë ata.
- **Qendra e librit.** Shfletimi apo leximi i librave u mundëson fëmijëve të mësojnë gjëra të reja, të gjenden në vende të tjera dhe të pasurojnë fjalorin me fjalë të reja. Sa më herët të nisë ky proces, aq më i dashur do të jetë ai kur fëmija rritet. Kur fëmijëve u jepet mundësia të shkëmbejnë libra me njëri-tjetrin, t'i shohin apo t'i

“lexojnë” sipas mënyrës së tyre, të dëgjojnë histori të regjistruara në magnetofon, të tregojnë histori familjare, të krijojnë vetë histori, atëherë ata janë të motivuar të bëhen lexues dhe shkruer të mirë në të ardhmen. Të lexuarit me zë të lartë është mënyra më e mirë për të nxitur dashurinë për librin dhe për t’i motivuar fëmijët të mësojnë të lexojnë; është, gjithashtu, çelësi për të zhvilluar aftësitë e lexim-shkrimit dhe shprehitë gjuhësore.

Qendra e bibliotekës duhet të jetë e pasur me librat më të bukur për fëmijë, me një “podium” për të treguar histori dhe me materiale shkrimi ku fëmijët të zbatojnë shprehitë dhe gjërat që mësojnë gjatë kohës së leximit. Koha e leximit duhet të jetë një veprimtari sociale e kënaqshme për ta, gjatë së cilës fëmijët zhvillojnë shprehitë e të dëgjuarit.

- **Qendra e zbulimit.** Fëmijët lindin dhe rriten me dëshirën për të mësuar rreth botës dhe shfaqin ndjenjën e habisë për botën që i rrethon. Kjo qendër është menduar *pikërisht* për të shpërthyer kuriozitetin e fëmijëve, një vend ku ata mund të gjejnë përgjigjet e pyetjeve të tyre. Në këtë qendër fëmijët përfitojnë shprehitë dhe koncepte për të cilat kanë nevojë në kopsht e në jetë. Gjetja dhe zbulimi i gjërave të reja ndodh në të gjithë mjedisin e klasës, por fëmijët kanë nevojë për një vend ku ata të eksperimentojnë, të hetojnë dhe të zbulojnë. Pra, në këtë qendër fëmijët nuk drejtohen për të mësuar fakte të caktuara shkencore, por të kryejnë prova dhe eksperimente, nëpërmjet të cilave i mësojnë ato.

Brenda kësaj qendre duhet të ketë vend për kërkime të qeta (vëzhgime dhe koleksione), për kërkime më aktive, që lidhen me magnetët, peshoren dhe matjet në të, pasqyrat, prizmat dhe eksplorime të zhurmshme (aktivitete që kanë lidhje me ujin, përzierjen e ngjyrave, mbjelljen e bimëve etj. Fëmijëve u bëhen pyetje, ndihmohen me këshilla, përsëritin disa herë një eksperiment në mënyrë që ata ta kuptojnë më mirë procesin që po kryejnë.

- **Qendra e ujit dhe e rërës.** Rëra dhe uji janë materiale natyrore që i joshin ndjenjat e fëmijëve. Ato janë çlodhëse dhe puna me to fal kënaqësi. Edhe pse rëra dhe uji janë dy veprimtari të ndara, këshillohet që ato të jenë pranë njëra-tjetrës si një fushë e vetme interesi. Materialet duhet të jenë të pranueshme për fëmijët, në

mënyrë që ata t'i përdorin dhe të kënaqen me to. Kjo mund të jetë një qendër e zhurmshme dhe mund të shkaktojë rrëmujë dhe papastërti në klasë. Materialet që përdoren më shumë në këtë qendër, janë: kova, lopata, krëhëri, format e ndryshme plastike etj.

- **Qendra e muzikës dhe e lëvizjes.** Muzika dhe lëvizja janë pjesë e jetës së përditshme të njeriut. Kur në klasë zhvillohen veprimtari muzikore ose lëvizore, për fëmijët nuk krijohen vetëm mundësi për t'i vënë në lëvizje apo për t'i bërë ata të lëvizin sipas një ritmi të caktuar, por njëkohësisht i zhvillojnë në fushat socio-emocionale, fizike, intelektuale dhe gjuhësore. Si të kënduarit, edhe të lëvizurit janë veprimtari që u falin fëmijëve shumë kënaqësi dhe bëjnë që çdo fëmijë të jetë pjesë e grupit. Këngët e thjeshta janë më të mirat për fëmijët e moshës 3-5 vjeç. Këngët familjare, ninullat apo lirikat janë të lehta për t'u mbajtur mend, si dhe për t'u praktikuar në shtëpi me ndihmën e prindërve. Në këtë qendër përdoren instrumente muzikore të vërteta ose imitacione, topa, litrë, fjongo, veshje sportive, kukulla etj. Meqë veprimtaritë janë të zhurmshme dhe fëmijët janë në veprimtari gjatë gjithë kohës, mund të krijohet mundësia që ata të veprojnë në të njëjtën kohë në këtë qendër.
- **Qendra e Gatimit.** Gatimi është një veprimtari zbavitëse dhe e vlefshme për shumë arsye: *së pari*, fëmijëve u pëlqen të bëjnë veprimtari që i bëjnë të rriturit; *së dyti*, gatimi i bën të aftë fëmijët të zhvillojnë mjaft shprehi dhe koncepte. Për të krijuar një qendër të tillë, duhet menduar për hapësirën që do të zërë ajo, për materialet dhe pajisjet e nevojshme, për organizimin dhe përdorimin e tyre, si dhe për masat e sigurisë që kanë lidhje me pajisjet që do të përdoren për të gatuar. Kur përgatitet një ëmbëlsirë, fëmijët bashkëpunojnë me kuzhinieren e kopshtit, ndërsa kur imitojnë procese gatimi, atëherë ata punojnë në qendër dhe përdorin materiale të tilla, si: argjilë, enë plastike, pajisje shtëpiake etj. Në këtë qendër fëmijët kanë mundësi të kërkojnë, të provojnë dhe të krijojnë produkte nga më të ndryshmet, pavarësisht cilësisë së tyre. Ata mund të kryejnë si procese të pavarura, edhe veprimtari të përbashkëta në grup.

Nëpërmjet planifikimeve të menduara nga mësuesja për punën në këtë qendër, fëmijët do të përjetojnë përvoja të suksesshme dhe të kënaqshme, dhe njëkohësisht do të mësojnë mjaft gjëra të reja, duke shfrytëzuar njohuritë dhe shprehjet e fituara në qendrat e tjera.

- **Qendra e Kompjuterit.** Kompjuteri është një mjet shumë i dobishëm në klasat e parashkollorit. Suksesi varet nga mënyra dhe qëllimi përse do të përdoret, si dhe nga *programet* e përshtatshme për moshën e fëmijëve.

Shumë ekspertë të fushës së fëmijërisë së hershme pohojnë se përdorimi i përshtatshëm i kompjuterit që në moshat e hershme, mund të ketë përfitime të vlefshme për ta. Gjatë lojës në kompjuter fëmija heton, përfshihet në veprimtari kërkimi, krijon besim në vetvete dhe krijon në mënyrë origjinale etj. Kompjuteri u jep fëmijëve mundësi zgjedhjeje të veprimtarive që ata dëshirojnë të kryejnë. Programet duhet t'u përkasin stileve të ndryshme të të nxënit dhe inteligjencave të shumëfishta. Mësuesja duhet t'i ndihmojë fëmijët të mbajnë qëndrim dhe të flasin rreth asaj që punojnë. Puna në kompjuter kryhet më mirë kur në të ulen 2-3 fëmijë.

KAPITULLI VII

VLERËSIMI

VLERËSIMI

Vlerësimi në fëmijërinë e hershme ka peshë të rëndësishme. Vlerësimi i fëmijës konsiderohet nxitje për më tej, është perceptim dhe dëshirë e fëmijës, se si ai/ajo paraqitet në sytë e tjetrit, nënës, babit, vëllait, motrës, mësuesit.

Vlerësimi përdoret si mjet për të mbështetur të nxënë të fëmijëve. Gjithashu format e vlerësimit ndihmojnë mësuesit të kuptojnë se si një fëmijë është duke përparuar në një fushë të caktuar të nxëni ose në një fushë specifike zhvillimi.

Nëpërmjet vlerësimit mund të identifikohen fëmijët që mund të jenë në rrezik ose mund të kenë nevojë për ndërhyrje të hershme dhe shërbime të arsimit të specializuar. Format e vlerësimit shërbejnë për mësuesin/en dhe prindin për të projektuar hapat e tjerë të të nxënit. Vlerësimi individual i fëmijës për qëllime të caktuara ka shumë rëndësi të dokumentohet.

Çështje të tilla, si: çfarë të dhënash duhet të mbledhim për arritjet dhe zhvillimin e fëmijëve, si do t'i mbledhim dhe si do t'i interpretojmë ato, janë dhe duhet të jenë objekt debati në të gjithë komunitetin shkollor.

Vlerësimi bëhet për të mbledhur informacion rreth zhvillimit, të nxënit dhe përfitimit të fëmijëve nga kurrikula, metodat e mësimdhënies, mjedisi dhe e gjithë veprimtaria mësimore-eduaktive.

Vlerësimi kryhet gjatë veprimtarive të përditshme në grup: kur fëmijët janë duke biseduar me fëmijët e tjerë ose me të rriturit, kur janë të përfshirë në lojëra dhe veprimtari individuale apo me të tjerë, kur janë duke bërë punime artistike ose duke ndërtuar me blloqe, kur janë duke ndenjur vetë dhe duke u marrë me sendet personale, kur janë duke u marrë me veprimtari fizike, duke ngrënë ose duke pushuar.

Një vlerësim cilësor dhe i paanshëm bazohet në kritere të vlefshme, transparente dhe të zbatueshme. Ky vlerësim i shërben përmirësimit të të nxënit, atëherë kur procesi ka karakter edukativ dhe motivues dhe mbështetet në kritere, si:

7.1 Vlefshmëria dhe konfidencialiteti

Vlerësimi është konfidencial, që do kuptuar se vlerësimi i mësuesit ndahet me prindin dhe me stafin në mënyrë konfidenciale dhe për qëllime të identifikimit të standardeve të arritura gjatë zhvillimit ose për identifikim të barrierave të të nxënit që janë konstatuar tek fëmija. Vlerësimi duhet të sigurojë informacion të vlefshëm për idetë, proceset, rezultatet dhe vlerat që priten të krijohen te fëmijët gjatë procesit mësimor - edukativ. Vlerësimi bëhet i vlefshëm kur është frekuent, i dokumentuar, konfidencial, dhe kur ndahet me familjen dhe prindërit.

7.2 Kriteri Arsimor në vlerësim

Vlerësimi në të gjitha rrethanat kryet me qëllim mbështetjen dhe ndihmën për fëmijën. Identifikimi i barrierave përgjatë të nxënit, konsiderohet vlerësim me qëllim të nxënit dhe nga kurrikula konsiderohet detyrim procedural dhe profesional dhe kompetencë e mësuesit. Që të luajë këtë rol, vlerësimi duhet:

- të jetë vlerësim frekuent,
- i dokumentuar,
- i qëllimshëm për objektiva të caktuara mësimore,
- identifikues i pikave të forta, dobëta gjatë të nxënit,
- stimulues, rritje të vetërespektit,
- vlerësim që rrit dhe zhvillon kuptimin për veten
- vlerësim përmes simbolikash si: flamuri, lule, yje etj.

7.3 Transparehca në vlerësim

Familja, prindërit gëzojnë të drejtën dhe kanë nevojë të njihen me kriteret me të cilat do të vlerësohen fëmijët e tyre. Kjo garanton sinkronizim të vlerësimit që vjen nga institucioni parashkollor me vlerësimin që vjen nga familja dhe prindërit.

7.4 Paanshmëria në vlerësim

Vlerësimi është i detyruar të përmbushet për çdo fëmijë përtej çdo lloj diskriminimi. Formatet e vlerësimit mbushen në mënyrë të paanshme në respekt të etikës që çdo mësues dhe çdo institucion përmbush funksionet e veta.

7.5 Vlerësim tërësor

Vlerësimi tërësor bëhet në respekt dhe në përmbushje të fushave të nxëniet, të rezultateve të pritshme, duke iu referuar fëmijës si individualitet i papërsëritshëm. Vlerësimi bëhet përtej çdo gjykimi, parapëlqimi dhe paragjykimi. Procesi i vlerësimit bëhet shumë i rëndësishëm sidomos në moshën 5-6 vjeçare, për të vlerësuar gadishmërinë e fëmijës për t'u regjistruar në shkollë.

SHTOJCË

BURIMET E LITERATURËS

BURIMET E LITERATURËS

- Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë
- Strategjia Kombëtare e Arsimit parauniversitar
- Korrniza Kurrikulare e Arsimit parauniversitar
- Dispozitat Normative
- Konventa për të drejtat e Fëmijës
- Psikologjia e zbatuar në mësimdhënie
- Teoritë rreth zhvillimit të fëmijës
- Manual për mësuesit në ciklin parashkollor
- Manual për mësuesit me fokus: gjithëpërfshirjen, dimensionin gjinor, diversitetin etj.
- Bodrova, E. & Leong, D. J. (2007). *Tools of the mind: The Vygotskian approach to early childhood education, 2nd edition.*
- Pearson Bredekamp, S. (2014). *Effective practices in early childhood education: Building a foundation.* Boston, MA: Pearson.
- California Department of Education. (2010). California preschool curriculum.
- Dodge, D. T., Colker, L. J. & Heroman, C. (2002). *Creative curriculum for preschool, 4th edition.* Teaching Strategies.
- Eliason, C. & Jenkins, L. (2008). *A practical guide to early childhood curriculum, 9th edition.* Pearson.
- Jackman, H., Beaver, N. & Wyatt, H. (2005). *Early education curriculum: A child's connection to the world.* Wadsworth Publishing.
- Marshall, B. (2007). *High/Scope step by step: Lesson plans for the first 30 days.* High/Scope Press.
- National Association for the Education of Young Children. (2008). *Curriculum: A guide to the NAEYC early childhood program standards and related accreditation criteria.* Washington, DC: NAEYC
- National Center for Quality Teaching and Learning. (2011). *Choosing a preschool curriculum.* Office of Head Start. Retrieved from www.edlrc.acf.hhs.gov

- Saylor, J. G. & Alexander, W. M. (1954). *Curriculum planning for better teaching and learning*. NY: Rinehart.
- Smith, B.O., Stanley, O. W., & Shores, H. J. (1957). *Fundamentals of curriculum development*. World Book Encyclopedia.
- Wiltshire, M. (2011). *Understanding the High/Scope approach: Early years in practice*.
Routledge.
- Berk, L. E., & Winsler, A. (1995). *Scaffolding children's learning: Vygotsky and early childhood education: NAEYC research into practice series, volume 7*. Washington, DC: NAEYC.
- Dunlap, L. L. (2004). *What all children need: Theory and application*. University Press of America.
- Erikson, E. H. (1993). *Childhood and society*. WW Norton & Company.
- Fischer, K. W. (1980). A theory of cognitive development: The control and construction of hierarchies of skills. *Psychological Review*, 87(6), 477.
- Forman, E. A., Minick, N. E., & Stone, C. (1993). *Contexts for learning: Sociocultural dynamics in children's development*. Oxford University Press.
- Gray, C., & MacBlain, S. (2012). *Learning theories in childhood*. Sage.
- Pinkham, A. M., Kaefer, T., & Neuman, S. B. (Eds.). (2012). *Knowledge development in early childhood: Sources of learning and classroom implications*. Guilford Press.
- Shute, R. H., & Slee, P. T. (2015). *Child development: Theories and critical perspectives*.
Routledge.
- Chard, S. C. (1998). *The project approach: Making curriculum come alive*. New York: Scholastic.
- Copple, C. (2012) *Growing minds: Building strong cognitive foundations in early childhood*.
Washington, DC: NAEYC
- Dell'Olio, J. M., & Donk, T. (2007). *Models of teaching: Connecting student learning with standards*. Sage Publications.
- Eliason, C. F., & Jenkins, L. T. (1981). *Practical guide to early childhood curriculum*.
CV

- Mosby.Epstein, A. S. (2006). *The Intentional Teacher: Choosing the Best Strategies for Young Children's Learning*. Washington, DC: NAEYC.
- Harlen, W., & James, M. (1997). Assessment and learning: differences and relationships between formative and summative assessment. *Assessment in Education*, 4(3), 365-379.
- Boat, M. B., Dinnebiel, L. A., & Bae, Y. (2010). Individualizing instruction in preschool classrooms. *Dimensions of Early Childhood* 38(1), 3-11.
- Bredekamp, S. & Copple, C. (Eds.). (2008). *Developmentally appropriate practice in early childhood programs serving children from birth through age 8, 3rd Ed.* Washington, DC: NAEYC.
- Derman-Sparks, L., LeKeenan, D., & Nimmo, J. (2015). *Leading anti-bias early childhood programs*. New York. NY: Teachers College Press.
- DeVries, R., Zan, B., Hildebrandt, C., Edmaiston, R., & Sales, C. (2002). *Developing constructivist early childhood curriculum: Practical principles and activities*. New York, NY: Teachers College Press.
- Epstein, A., Schweinahrt, L., DeBruin-Parecki, A., Robin, K. B. (2004). *Preschool assessment: A Guide to Developing a balanced approach*. New Brunswick, NJ: NIEER.
- Gonzalez, N. Moll, L. C., & Amanti. C. (Eds.). (2005). *Funds of knowledge: Theorizing practices in households, communities, and classrooms*. New York, NY: Routledge.
- Gullo, D. (2005). *Understanding assessment and evaluation in early childhood education, 2nd Ed.* New York, NY: Teachers College Press.
- Howell, J. & Reinhard, K. (2015). *Rituals and traditions: Fostering a sense of community in preschool*. Washington, DC: NAEYC.
- Keyser, J. (2007) *From parents to partners*. Washington, DC: NAEYC.
- NAEYC & DEC. (2009). Early childhood inclusion position statement. Washington, DC: NAEYC.
- National Professional Development Center on Inclusion. (2009). *Research synthesis pointson early childhood inclusion*. Chapel Hill: The University of North Carolina.

- Riley-Ayers, S. (2014). *Formative assessment guidance: A CEELo fast fact*. Washington,DC: CEELo.
- Riley-Ayers, S., Stevenson-Garcia, J., Frede, E., & Brenneman, K. (2012). *The early learning scale*. Carson, CA: Lakeshore Learning Materials.
- Snow, C. & Van Hammel, S. (2008). *Early childhood assessments: What, why & how*. Washington, DC: National Academies Press.
- Aaronson, S. (2012). *Healthy young children: A manual for programs, 5th Ed*. Washington,DC: NAEYC.
- Cryer, D., Harms, T., & Riley, C. (2003). *Ala about the ECERS-R: A detailed guide in words and pictures to be used with the ECERS-R*. New York: Teachers College Press.
- Curits, D., Brown, K.L., Baird, L., & Coughlin, A.M. (2013). Planning environments and materials that respond to young children’s lively minds. *Young Children* September, 2013, 26-31.
- Curtis, D. & Carter, M. (2003). *Designs for living and learning*. St. Paul, MN: Redleaf Press
- Gestwicki, C. (2013). *Developmentally appropriate practice: Curriculum and development in early education*. Boston, MA: Cengage Learning.
- Bredekamp, S. (2014). *Effective practices in early childhood education: Building a foundation*. Boston, MA: Pearson.
- Coughlin, P., Hansen, K., Heller, D., Kaufmann, R., Stolberg, J., & Walsh, K. (1997).
- *Creating child-centered classrooms: 3-5 year olds. Step by step: A program for children and families*. Washington, DC: Children’s Resources International.
- Galinsky, E. (2010). *Mind in the making: The seven essential life skills every child needs*.
- New York, NY: Harper Helm, J. H. & Katz, L. G. (2010). *Young investigators: The project approach in the early years, 2nd Ed*. New York, NY: Teacher College Press.
- Hyson, M. (2008). *Enthusiastic and engaged learners: Approaches to learning in the early childhood classroom*. New York, NY: Teachers College Press.

- Wien, C.A. (Ed.). (2008). *Emergent curriculum in the primary classroom: Interpreting the Reggio Emilia Approach in schools*. New York, NY: Teachers College Press.
- Eliason, C. & Jenkins, L. (2016). *A practical guide to early childhood curriculum*. Boston, MA: Pearson.
- Trister Dodge, D. Colker, L., Herman, C. (2011). *The creative curriculum for preschool, vol. 2*. Washington, DC. Teaching Strategies
- Wien, C.A. (Ed.). (2008). *Emergent curriculum in the primary classroom: Interpreting the Reggio Emilia approach in schools*. New York, NY: Teachers College Press

